

magazina. evropiane

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society

| Korrik 2010 | numri 2 |

LIBERALIZIMI I VIZAVE

REJECTED

Kosovo
the young
europeans

ISOLATED

KOSOVO-YOUNG.COM

liberalizimi

DEKALOGU I GETOS – I RIVIZITUAR

Të nderuar lexues,

Kosova vazhdon të jetë vendi më i izoluar në botë dhe vendi më i lënë pas dore në rajon. Shumë shtete ende nuk e kanë njohur pasaportën kosovare, dhe një pjesë e madhe e kufijve të saj janë të pakalueshëm. Me gjithë rekomandimet e premtimet e Komisionit Evropian, Kosovës ende nuk i janë ofruar politika afirmative për ta ndryshuar këtë situatë. Edhe pse një numër i deputetëve të Parlamentit Evropian kanë filluar të jenë më të zëshëm në këtë drejtim, Kosovës ende nuk i është ofruar Udhërrëfyesi çfarë u është ofruar vendeve të rajonit.

Vitin e kaluar "Forumi 2015", projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, prezantoi një varg të fakteve që argumentojnë qartë izolimin e Kosovës. Për fat të keq, këto fakte ende mbesin aktuale edhe sot:

1. Përderisa kosovarët vitin e kaluar ishin popull më i refuzuar në Ballkan, kur aplikonin për viza Schengen (37% të aplikacioneve), më 1 janar 2011, do të mbetemi të vetmit që do të na duhej viza Schengen për të udhëtuar në Evropë.
2. Përderisa vitin e kaluar kemi qenë populli me shpenzimet më të larta në Ballkanin Perëndimor për të aplikuar për vizë, më 1 janar 2011 do të jemi të vetmit që do të vazhdojmë të shpenzojmë mesatarisht 120 euro, apo rreth 60% të rrogës mesatare të Kosovës, për të kompletuar aplikacionin.
3. Kosovarët vazhdojnë ta kenë lirinë e udhëtimit pa viza në vetëm 4 shtete të botës, ndërsa afganët, somalezët dhe iranianët udhëtojnë në mbi 20 shtete pa viza.
4. Përderisa liria e lëvizjes në rajon po avancet deri në udhëtim pa viza në Bashkimin Evropian, kosovarët vazhdojnë të jenë të izoluar edhe brenda rajonit. Ende na duhen viza për të udhëtuar për në Bullgari, Rumani, Greqi dhe Kroaci, ndërsa pasaporta e Republikës mbetet dokument i papranueshëm për Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë.
5. Pasaporta e Kosovës është një dokument udhëtimi i pranuar zyrtarisht nga 64 shtete (krahasuar me 55 një vit më parë). Prej tyre 43 janë deklaruar zyrtarisht për pranimin e këtij dokumenti si valid për udhëtim në teritoriet e tyre, ndërsa kosovarët kanë raportuar në ueb-faqen kosovothanksyou.com të kenë udhëtuar edhe në 23 shtete të tjera.

6. Kosova është i vetmi vend në Ballkan që Bashkimi Evropian nuk i ka ofruar udhërrëfyes për liberalizimin e vizave.

7. Kosova është i vetmi vend në Ballkan që ka miratuar dhe ka filluar të përmbushë "Udhërrëfyesin vetjak për implementimin e kriterëve për procesin e liberalizimit të vizave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian".

8. Kosova vazhdon të ketë më së paku kontrata bashkëpunimi me vendet e BE-së dhe vende të tjera, në bazë të të cilave do të pranoreshin punëtorë, studentë ose cilado formë tjetër e shkëmbimit të përvojave me këto vende. Niveli i ulët i punësimit bashkë me mungesën e perspektivës bën që shumë qytetarë të mendojnë të migrojnë.

9. Kosova vazhdon të ketë më së paku qasje dhe anëtarësi në struktura ndërkombëtare, ndërqeveritare e rajonale; edhe dy vjet pas shpalljes së shtetësisë, ajo mbetet e injoruar nga ueb-faqet zyrtare dhe komerciale, të cilat veprojnë edhe nga shtete të cilat e kanë njohur shtetësinë, ndërsa eksporti i prodhimeve kosovare bllokohet nga disa vende fqinje.

10. Viza Schengen që u miratohet bartësve të pasaportës kosovare nuk është vizë klasike. Kjo vizë "minuson" një sërë shtetesh në të cilat nuk mund të udhëtohet, e në disa raste liston vetëm një numër syresh ku mund të udhëtohet.

Rishikimi i dekalogut të izolimit nga viti i kaluar është brengosës për faktin se pasqyron një situatë më të përkeqësuar se një vit më herët, kur është publikuar për herë të parë. Ky regres i lirisë së lëvizjes së kosovarëve duhet rikthyer në drejtim të kundërt. Bashkimi Evropian duhet t'i shikojë këto fakte me vëmendje dhe të mobilizojë vullnetin politik nga qeveritë e të gjithë anëtarëve të vet për t'i ofruar Kosovës Udhërrëfyesin sa më parë. Prandaj, ky numër i revistës evropiane i dedikohet kësaj problematike në mënyrë që ta mbajë atë aktuale vazhdimisht dhe të theksojë nevojën për politika konkrete të BE-së ndaj Kosovës. Prandaj, ky numër sjell një sërë artikujsh që i bëjnë mu këtë thirrje Evropës.

Lexim të këndshëm!

Iliriana Kaçaniku

Revista është iniciuar dhe realizuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinione të autorëve të artikujve të publikuar nuk përfaqësojnë qëndrimet e Fondacionit. • Bordi Editorial: Luan Shllaku, Agron Bajrami, Venera Hajrullahu, Iliriana Kaçaniku, Fatmir Curri, Ilir Deda e Alban Zogaj. Design & Layout: Sami Kçiku. • Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - Adresa: Ulpiana, Imzot Nikëprellaj, Villa Nr. 13, 10000, Prishtinë; tel.: 038 542 157; e-mail: info@kfos.org

NË KËTË NUMËR

LIBERALIZIMI I VIZAVE

BALLKANI NË PROCESIN E
LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Fatmir Haxholli
& Jeton Zulfaj

Faqe 4

LIBERALIZIMI I VIZAVE
VETËM NJË HALLKË E INTE-
GRIMIT NË BE
Hajredin Kuçi

Faqe 6

LIBERALIZIMI I VIZAVE - NJË
NXITJE E DOMOSDOSHME
Ulrike Lunacek

Faqe 8

KRITERET E QARTA, POR
TRAJTIMI JO I BARABARTË
I KOSOVËS -
Augustin Palokaj

Faqe 10

LIBERALIZIMI I VIZAVE DHE
KOSOVA¹
Renzo Daviddi

Faqe 12

HOLLËSI DHE IMTËSI PARA
LËVIZJES SË LIRË
Enver Robelli

Faqe 14

PSE KA RËNDËSI LIBERALIZI-
MI I VIZAVE DHE PSE TANI?
Verena Knaus

Faqe 16

KOSOVA "SUI GENERIS"
EDHE NË PROCESIN E LIBER-
ALIZIMIT TË VIZAVE
Gjeraqina Tuhina

Faqe 18



PROCESI I LIBERALIZIMIT TË
VIZAVE, TË ARRITURAT,
PËRGJEGJËSITË DHE
OBLIGIMET
Besnik Vasolli

Faqe 20

APEL I KOSOVËS UDHËHE-
QËSVE DHE VENDIMMAR-
RËSVE EVROPIANË

Faqe 22

SEKTORI I SIGURISË NË KON-
TEKST TË PROCESIT TË LIBER-
ALIZIMIT TË VIZAVE
Florian Qehaja

Faqe 23

UDHËRRËFYESI I SHQIPËRISË
PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE
ME BE-në (2 qershor 2008)

Faqe 25

PËRTEJ PRIT-DHE-SHIH: RRUGA
PËRPARA E POLITIKËS SË BE-SË
NDAJ BALLKANIT
(Heather Grabbe, Gerald
Knaus dhe Daniel Korski)

Faqe 29

liberalizimi

BALLKANI NË PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Fatmir Haxholli
& Jeton Zulfaj



Aktualisht një prej proceseve më të rëndësishme për vendet të cilat aspirojnë integrimin në Bashkimin Evropian (BE) është procesi i heqjes së regjimit të vizave, madje ky proces për nga rëndësia që ka radhitet menjëherë pas aspiratës që kanë vendet për anëtarësim në BE. Deri tani vetëm tri vende ballkanike kanë mbetur jashtë liberalizimit të vizave dhe si pasojë qytetarët e këtyre shteteve (Bosnjë-Hercegovina, Shqipëria dhe Kosova) duhet të pajisen me viza për të hyrë në vendet e BE-së. Kur bëhet fjalë për procesin e heqjes së vizave, nënkuptohet vetëm krijimi i mundësive për lëvizje të lirë të qytetarëve të vendeve që e kanë arritur këtë marrëveshje me 25 vendet e zonës Schengen. Këtu përfshihet edhe Zvicra, Islanda dhe Norvegjia, si dhe dy vende që janë anëtare të BE-së, por jo të zonës Schengen (Bullgaria dhe Rumania) dhe së fundi edhe tri vendet ballkanike, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia. Interes për t'u bërë anëtare të zonës Schengen kanë shprehur edhe Lichtenstajni dhe Vatikani. Duhet përmendur se Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë anëtare të marrëveshjes, respektivisht zonës Schengen, por që bashkëpunojnë në çështje të drejtësisë dhe ato kriminale. Megjithatë, në këto dy vende nuk mund të udhëtojnë pa viza qytetarët e vendeve të Ballkanit që kanë arritur marrëveshje për heqjen e vizave me vendet anëtare të zonës Schengen. Në këtë drejtim marrëveshjet për heqjen e vizave nuk janë të barasvlershme më të qenit vend nënshkrues i kësaj marrëveshjeje – pjesë e zonës Schengen.

Pengesat të cilat pamundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve të vendeve, të cilat ende nuk kanë arritur marrëveshje për heqjen e vizave – Bosnja, Shqipëria dhe Kosova – dëmtojnë ndjeshëm qytetarët e këtyre vendeve si në aspekt të kohës, perceptimit, trajtimit dhe, para së gjithash, të shpenzimeve për xhepin e varfër personal apo buxhetin e kufizuar familjar të tyre. Për më shumë, kjo situatë ka edhe efekte tejet të dëmshme sociale dhe kulturore, duke qenë se i mban këta qytetarë në një pozitë të papranueshme në krahasim me qytetarët e vendeve të tjera, të cilat kanë arritur të heqin vizat, apo atyre që tashmë janë pjesë e zonës Schengen.

Ky numër i revistës do të trajtojë aspektet kryesore të liberalizimit, apo më saktë, heqjes së regjimit të vizave, progresin dhe sfidat që po has Kosova në këtë drejtim, rëndësinë që kanë institucionet dhe aktorët e tjerë në lidhje me këtë proces, sikurse do t'i qaset gjendjes delikate në të cilën janë gjetur qytetarët e Kosovës në lidhje me të drejtën e tyre njerëzore për të qenë qytetarë të barabartë në kuptim të lëvizjes së lirë.

Por para se t'u qasemi këtyre temave do të ofrojmë një kronologji të shkurtë të rrugëtimit të vendeve të Ballkanit në heqjen e vizave, si dhe atyre që tashmë janë në prag të heqjes. Rasti i Kosovës do të trajtohet me hollësi duke vazhduar të jetë një situatë, e cila premtonte heqjen e vizave, por që njëkohësisht përcillet me komplikime të veçanta për Kosovën, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit.

Çka nënkupton liberalizimi i vizave?

Qytetarët e shtetit ndaj të cilit Bashkimi Evropian heq regjimin a vizave, mund të udhëtojnë në 28 shtete vetëm me pasaportë biometrike. Pasaportat e tyre vulojnë kur të kalojnë kufirin e një vendi Schengen. Vula u jep të drejtë atyre të qëndrojnë në zonën Schengen deri në 3 muaj (90 ditë), pas çdo gjashtë muajsh (180 ditë).

Perspektiva reale e integritit të vendeve të Ballkanit në Bashkimin Evropian u hap në Samitin e Zagrebit në vitin 2000, kur u hap Procesi i Stabilizim-Asociimit me Ballkanin, dhe njëkohësisht u krijua Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) si dokument i BE-së, i veçantë për Ballkanin, me të cilin fillohej procesi i integritit. Kosova nuk përmendej fare në deklaratën finale të Samitit të Zagrebit duke u lënë pothuajse jashtë procesit. Perspektiva evropiane së bashku me MSA-të riafirmohen edhe një herë në Samitin e Selanikut në Greqi në vitin 2003, duke lënë të kuptohet se vendet e Ballkanit do t'i bashkëngjiten BE-së sapo të përmbushin kriteret. Për dallim nga Zagrebi, në Selanik përmendet edhe emri i Kosovës. Edhe pse prezantuar në vitin 2000, MSA-të u nënshkruan shumë më vonë nga vendet e Ballkanit. Shqipëria e nënshkroi në vitin 2006, Bosnjë-Hercegovina më 2008, Mali i Zi më 2007, Serbia më 2008, kurse të parat ishin Kroacia dhe Maqedonia në vitin 2001.

Në përgjithësi deri tek marrëveshjet për facilitim të vizave dhe marrëveshjet për riatdhesim, procesi i liberalizimit të vizave nuk ishte temë e bisedimeve me BE-në, edhe pse në MSA-në me Shqipërinë në vitin 2006, në kuadër të artikullit 80 të Marrëveshjes ekzistonte një deklaratë e përbashkët ku thuhej se "palët janë të vetëdijshme për rëndësinë që populli dhe Qeveria e Shqipërisë i kushtojnë perspektivës së liberalizimit të regjimit të vizave...". Megjithatë procesi i heqjes së regjimit të vizave fillon me nënshkrimin e marrëveshjeve për facilitim të vizave. Në këtë drejtim, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor¹ nënshkruan marrëveshjet për facilitimin e vizave në vitin 2007, dhe ato hynë në fuqi në janar 2008. Kosova nuk ishte e përfshirë në këtë proces dhe si pasojë nuk përfitoi nga procesi i facilitimit të vizave për qytetarët e Ballkanit, duke mbetur e izoluar.

Marrëveshjet për facilitim të vizave me Ballkanin parashikonin lehtësimin e procedurave të marrjes së një vize Schengen në dy drejtime; shkurtimin e kthimit të përgjigjes për vizë brenda një muaji (30 ditë) dhe uljen e pagesës për vizë. Kohëve të fundit BE-ja nxori një kod të ri për vizat për të gjitha vendet e treta, i cili aplikohet nga 5 prill 2010. Ky kod aplikohet për 25 shtetet e zonës Schengen në të gjithë botën dhe do të bëjë që marrja e një vize Schengen të jetë më e shpejtë dhe më e lehtë. Kodi aplikohet për ata që aplikojnë për viza për qëndrim të shkurtër me kohëzgjatje

Çka është Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA)?

PSA është politikë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor e filluar në Samitin e Zagrebit në vitin 2000. PSA synon sigurimin e paqes dhe të stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe përkrahje për forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit. Njëkohësisht PSA synon krijimin e marrëdhënieve speciale mes vendeve të Ballkanit dhe BE-së duke i njohur kështu këto si kandidate potenciale për anëtarësim në BE.



deri në 90 ditë. Afati i intervistës për vizë shkurtohet në dy javë, kurse dhënia ose jo e vizës duhet të bëhet brenda 15 ditëve dhe jo më larg dhe se me këtë kod çdo refuzim i vizës duhet të përcillet me sqarime të nevojshme, kurse aplikuesit e pakënaqur do të kenë të drejtë apelimi. Natyrisht se Kosova do të përfitojë nga ky kod për shkak se ai tashmë është universal.

Në fillim të vitit 2008, pothuajse të gjitha shtetet e Ballkanit, me përjashtim të Kosovës, fillojnë dialogun për liberalizimin e vizave dhe nga mesi i po të njëjtit vit të gjitha këto shtete pranojnë udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave me kriteret të qarta, të cilat këto shtete duhet t'i plotësonin për liberalizim eventual të vizave. Progresi i shteteve ishte i ndryshëm në përbushjen e kriterëve dhe nga 5 shtete të Ballkanit që morën udhërrëfyesit, vetëm 3 prej tyre më 19 dhjetor 2009, fituan liberalizimin e vizave. Qytetarët e Serbisë, Maqedonisë dhe të Malit të Zi nga 19 dhjetori 2009 udhëtojnë lirshëm në të gjitha vendet e BE-së vetëm me një pasaportë biometrike, kurse Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina nuk morën vlerësim pozitiv nga Komisioni dhe si pasojë për këto vende u shty vendimi për liberalizim. Kosova në anën tjetër nuk ishte pjesë e vlerësimit, pasi ajo nuk kishte pranuar udhërrëfyes nga BE-ja. Tashmë dihet që Komisioni i ka reko-

manduar Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Ministrave liberalizimin e vizave edhe me Shqipërinë dhe Bosnjën dhe pritet që vendimet në Parlament dhe në Këshill të jenë pozitive dhe të merren aty nga fundi i vjeshtës ose fillimi i dimrit. Në këtë drejtim Kosova mbetet edhe më shumë e izoluar, tashmë edhe ndaj vendeve fqinje, të cilat do të fillojnë aplikimin e rregullave të reja të sigurisë për shkak të liberalizimit të vizave me BE-në.

Kjo është pak a shumë kronologjia e procesit të liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor. Është më se e qartë se Kosova nuk ishte pjesë e këtij procesi dhe si pasojë nuk ka përfituar nga ai. Në aspektin kohor nëse shikojmë progresin e vendeve të rajonit, dhe nëse këtë verë pranojmë udhërrëfyesin për viza, afti ideal për liberalizim do të ishte nga vjeshta apo dimri i vitit 2011. Gjithsesi deri atëherë lajmi i mirë është futja në fuqi e kodit të ri për viza nga BE-ja, që lehtëson jashtë mase marrjen e një vize Schengen, kurse heqja e plotë e regjimit të vizave do të varet shumë nga progresi që shënojnë institucionet e Kosovës në përbushjen e kriterëve tashmë të njohura për ne.

¹ Me përjashtim të Kroacisë e Sllovenisë, të cilat s'kishin nevojë për marrëveshje të facilitimit të vizave, pasi qytetarët e tyre udhëtonin lirshëm pa viza prejse kanë qenë pjesë e perandorisë Habsburge

LIBERALIZIMI I VIZAVE VETËM NJË HALLKË E INTEGRIMIT NË BE

Hajredin Kuçi



Liberalizimi i vizave për vendet aspiruese për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) nuk mund të shihet ndaras nga konteksti i përgjithshëm i marrëdhënieve të Republikës së Kosovës me BE-në. Procesi i liberalizimit të vizave paraqet vetëm njërin nga hallkat e shumta në rrugën e integrimit të vendit tonë drejt BE-së. Prandaj, për të kuptuar procesin e liberalizimit të vizave me Kosovën vështirësitë dhe dinamikën e punës, duhet që pashmangshmërisht të analizojmë marrëdhëniet e përgjithshme të Kosovës me BE-në. Përndryshe, tendenca për anashkalimin e faktorëve të përgjithshëm që përbëjnë raportet e Kosovës me BE-në do të na orientonte drejt një analize të mangët dhe jo reale. Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së janë definuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën. Megjithatë në debate të ndryshme akademike ende ngrihet dilema e mundësisë së anëtarësimit të Kosovës në BE, në aspektin praktik dhe politik nuk ka asnjë argument që mund të sfidojë të ardhmen e Kosovës në familjen evropiane.

Përcaktimi i perspektivës evropiane paraqet *conditio sine qua non* (kusht pa të cilin nuk bën), megjithatë perspektiva e ofruar kërkon që të shoqërohet me politika dhe udhërrëfyes të qartë që do të mundësonin qartësimin e rrugëtimit tonë drejt anëtarësimit në BE.

Në këtë drejtim Kosova merr pjesë në Procesin e Stabilizim Asociimit, vazhdon të përfshihet në iniciativat rajonale dhe evropiane për bashkëpunim dhe zhvillim dhe vazhdon të përfitojë nga asistencë teknike dhe financiare e BE-së.

Megjithatë, Kosova për dallim nga vendet e tjera të rajonit, ende nuk ka marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe ende nuk ka definuar në mënyrë formale statusin e saj me BE-në.

Prandaj qasja e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës është jo e plotë dhe jo tërësisht e koordinuar. Përderisa BE-ja ka përcaktuar politikën e saj për pranimin e Kosovës (kujto deklaratat e baroneshës Ashton dhe të komisionerit Fuele dhe një sërë rezolutash të Parlamentit Evropian), me gjithë faktin që BE-ja vazhdon të jetë kontribuuesi më i madh financiar në Kosovë, mungesa e marrëdhënieve direkte formale padyshim se vështirëson përcaktimin e dinamikës politike dhe koordinimit të politikave ditore.

Duke kuptuar vështirësitë politike, mosnjohjen e Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe vështirësitë e tjera në terren, na bën të kuptojmë se procesi i liberalizimit të vizave, ashtu sikurse i tërë procesi i integrimit evropian shoqërohet me sfida të shumta, të cilat jo domosdo bien vetëm mbi kompetencat dhe përgjegjësinë e institucioneve vendore. Por me gjithë këtë realitet sfidues, vendi ynë ka vënë si prioritet primar integrimin në Bashkimin Evropian dhe kjo rrjedhimisht nënkupton edhe plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave si pjesë e një tërësie për integrimin e plotë të vendit. Që nga shpallja e pavarësisë institucionet e vendit tonë me seriozitetin më të madh kanë ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të zhvilluar komunikimin politik me Brukselin zyrtar, për të definuar perspektivën evropiane dhe është përkushtuar për të inkorporuar, adoptuar dhe zbatuar rregullat dhe

standardet e përbashkëta evropiane të vendosura nga Komuniteti Evropian për dekada me radhë. Këto kriterë për anëtarësim në BE, të formësuar në Këshillin e Kopenhagës dhe të Madridit, paraqesin planin zhvillimor të punës së institucioneve tona dhe agjendën ditore të çdo shërbyesi civil dhe politik.

Këto kriterë për integrimin e përgjithshëm të vendit në BE janë padyshim stabiliteti i institucioneve të vendit, zhvillimi i demokracisë, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, krijimi i një ekonomie funksionale të tregut dhe kapaciteti i tregut tonë për të vepruar në kushtet e konkurrencës së tregut evropian, funksionimi i mirëfilltë i administratës publike dhe mbi të gjitha harmonizimi i legjisllacionit vendor me atë të Komunitetit Evropian.

Varësisht nga faza e plotësimit të kriterëve të lartcekura përcaktohet edhe dinamika dhe raporti i vendit aspirues me Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim do të ishte e domosdoshme që në procesin e liberalizimit të vizave Kosova të ketë menaxhim dhe kontroll efektiv në kufijtë e saj territorial, të ketë një regjistrim civil të popullsisë, të rrisë sigurinë e dokumentacionit, të rregullojë çështjen e ripranimit dhe emigrantëve dhe kështu me radhë.

Kosova ka përcaktuar një agjendë tejet dinamike në plotësimin e të gjitha kriterëve, porse katalizatori i përshpejtimt të këtij procesi do të ishte dorëzimi i udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Vetëm pas posedimit të udhërrëfyesit të BE-së për liberalizimin e vizave, Kosova do ta ketë të qartë afatin

kohor për t'u inkuadruar në listën e "bardhë" të Schengenit.

Por, me gjithë këtë sfidë, Kosova ka vazhduar të rrisë kontrollin kufitar, të luftojë krimin e organizuar, është në prag të kompletimit të legjislacionit sa i përket ripranimit të personave të zhvendosur dhe regjistrimit civil dhe si një çështje teknike, por jo më pak e rëndësishme, Kosova ka filluar të përgatitet për ofrimin e pasaportave biometrike, të cilat paraqesin një kusht të domosdoshëm në këtë proces.

Procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën, me gjithë që paraqet një raport bilateral në mes të Kosovës dhe BE-së, ajo assesi nuk mund të shikohet ndaras nga konteksti i zhvillimeve rajonale.

Gjatë këtij viti tri shtetet kufitare me vendin tonë, përkatësisht Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, përfituan nga liberalizimi i vizave, duke u krijuar mundësi dy shteteve të tjera fqinje, Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, që brenda një periudhe të shkurtër kohore t'i bashkëngjiten grupit të shteteve të Ballkanit Perëndimor të cilat thyejnë murin e lëvizjes me Bashkimin Evropian. Me këtë trend të zhvillimit rajonal Kosova vazhdon të mbetet shteti i vetëm në rajon që nuk ka udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, por raportin e saj me BE-në e realizon nëpërmjet mekanizmit të ashtuquajtur "dialogu për viza". Padyshim se Brukseli zyrtar është i vetëdijshëm për realitetin e krijuar në rajon, prandaj shumë shpejt pritet që Kosovës t'i dorëzohet udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave dhe rrjedhimisht të

gjendet formula e konsensusit evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me gjithë këtë trajtim të veçantë, Kosova në vazhdimësi ka përshëndetur inkuadrimit e shteteve fqinje në procesin e liberalizimit të vizave dhe është e interesuar që të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor sa më parë të përmbyllin ciklin e heqjes së barrierave për lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Padyshim se liria e lëvizjes, përveç që paraqet një parim fundamental në kuptim të lirive dhe të drejtave të njeriut, heqja e vizave për qytetarët e shteteve të rajonit brenda një kohe shumë të shkurtër ka rezultuar edhe me rritjen e të ardhurave publike të realizuara nga shtimi i numrit të fluturimeve ajrore dhe tokësore dhe rritja e bashkëpunimit tregtar me qytetarët e tjerë evropianë. Duke marrë parasysh raportet aktuale të BE-së me Kosovën, mungesën e një udhërrëfyesi të qartë që do ta bënte Kosovën të barabartë me shtetet e rajonit dhe duke parë trendin e zhvillimeve në rajon, Bashkimi Evropian besoj që do të analizojë në thellësi sensitivitetin e rastit të Kosovës karshi proceseve rajonale në mënyrë që assesi qytetarët e vendit tonë të mos ndihen të diskriminuar në rajon. Kosova është e gatshme të mbetet mbrapa të tjerëve vetëm nëse kjo vjen si rezultat i mungesës së vullnetit të institucioneve të vendit, por në rast se ky proces neglizhohet si mungesë e një konsensusi politik në BE, atëherë Evropa do të vendoste jo në përputhshmëri me investimin e bërë afatgjatë në Kosovë dhe

politikën e saj strategjike për zhvillimin e rajonit në një trend të përbashkët.

Institucionet supranacionale në Bashkimin Evropian, e në veçanti Parlamenti Evropian, ka ngritur me shqetësim mundësinë e një getoizimi eventual të qarkullimit të qytetarëve tanë, duke sqaruar kështu se politika evropiane duhet të jetë e koordinuar në proceset e Ballkanit Perëndimor, por padyshim se çelësi për dorëzimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave dhe trajtimin e barabartë të qytetarëve të Kosovës gjendet në institucionin qendror vendimmarrës, në Këshillin Evropian.

Me gjithë mungesën e një konsensusi formal në nivel vendimmarrës, BE-ja vazhdon që nëpërmjet "dialogut për viza" të fuqizojë perspektivën e vendit tonë dhe të përkrahë institucionet e vendit me ekspertizën e Komisionit Evropian. Duke kujtuar kështu përkrahjen e fuqishme profesionale që vjen veçanërisht nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian, Kosova është në prag të formësimit të bazës ligjore dhe plotësimit të kriterëve të tjera teknike, si parakusht për liberalizimin e vizave. Ky përkushtim i institucioneve të vendit mundëson që në momentin e marrjes së udhërrëfyesit për viza, Kosova të kalojë shumë shpejt testin e maturimit institucional dhe politik për t'u bërë pjesë e listës së bardhë të Schengenit.

Vlen të theksohet se liberalizimi i vizave paraqet vetëm një etapë në rrugëtimin tonë drejt integritetit në Bashkimin Evropian. Modeli i institucioneve të BE-së që do të përdoret për liberalizimin e vizave me qytetarët e Kosovës nuk do të paraqesë vetëm përfundimin e kësaj etape, por do të krijojë një model që do të shërbejë për bashkëpunimin e mëtutjeshëm të Kosovës me institucionet vendimmarrëse të BE-së. Kosova, vazhdon të mbetet vendi me investimin më të madh financiar dhe politik të BE-së, prandaj gjetja e modelit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës është e pashmangshme, pasi që ky është interesi nacional i vendit tonë dhe ky është qëllimi i investimit afatgjatë të Bashkimit Evropian në Kosovë.

(Autori është zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës)



LIBERALIZIMI I VIZAVE - NJË NXITJE E DO- MOSDOSHME

Ulrike Lunacek



Të rinjtë në Kosovën e sotme – e Kosova është vendi i Ballkanit Perëndimor me numrin më të lartë të të rinjve! – kujtojnë prindërit e tyre duke u thënë se sa lehtë ishte për ata të udhëtonin në të gjitha pjesët e Evropës pa pasur nevojë për të pritur në radhë në konsullata, pa paguar një tarifë të pakthyeshme madje pa ditur nëse kërkesa për vizë do të pranohet apo jo. Për të gjithë ata të rinj (madje edhe për fqinjët e tyre në Bosnjë-Hercegovinë tash për tash), vendet anëtare të BE-së mbesin si tokë e premtuar ku nuk u lejohet të hyjnë – apo u lejohet vetëm në rrethana jashtëzakonisht të vështira dhe të kushtueshme. Si do ta zbulojnë ata se si duket Evropa - kjo "tokë e premtuar"? Si do të mësojnë ata të kuptojnë pasurinë e diversitetit dhe të mirëkuptimit kur ata nuk lejohen të dalin nga vendi i tyre dhe t'i hulumtojnë të tjerët, siç kemi bërë shumë nga ne evropianët perëndimorë kur ishim të rinj, për shembull përmes "interrail-it"?

Veçanërisht në Kosovë, vendi më i ri në rajon me një histori të dhimbshme, të vështirë, por gjithashtu të suksesshme dhe me një pavarësi që sapo ka mbushur dy vjet, procesi i integritetit në BE duhet të ngjallë pritje si dhe t'i përmbyshë ato brenda një periudhe kohore te pranueshme.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Parlamenti Evropian (PE) është bërë bashkëvendimmarrës për çështjen e vizave. Pak para se të miratohej Traktati, PE-ja e bëri të qartë pozicionin e vet për liberalizimin e vizave, më 12 nëntor 2009, duke e miratuar propozimin e Komisionit për çështjen e vizave

të bërë katër muaj më herët. Ky mendim fuqishëm mbështeti propozimin e Komisionit për heqjen e regjimit të vizave për Serbinë, FYROM dhe Malin e Zi, dhe njëkohësisht kërkoi që marrëveshjet me Bosnjë-Hercegovinën dhe Shqipërinë të mbylleshin sa më shpejt sapo këto dy vende të përmbushin të gjitha standardet, dhe gjithashtu theksoi nevojën që Komisioni të fillojë një dialog për vizë me Kosovën dhe të krijojë një udhërrëfyes për liberalizim të vizave të ngjashëm me ato të vendeve të tjera në rajon sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo reflektoi në konkluzionet e Këshillit për procesin e zgjerimit/stabilizim-asociimit më 7 dhe 8 dhjetor 2009, që përmbyllën me sukses procesin e liberalizimit të vizave me Serbinë, FYROM dhe Malin e Zi, por gjithashtu ndërmoren një hap të rëndësishëm për Kosovën, pasi Këshilli i kërkoi Komisionit një "qasje të strukturuar për të sjellë qytetarët e Kosovës më pranë BE-së". Duke pasur parasysh faktin se pesë shtete anëtare të BE-së ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, kjo ishte më së shumti që mund të pritej – dhe kjo gjithashtu e ngarkoi qartazi Komisionin me detyrën përfundimisht për të nisë procesin e liberalizimit të vizave. Unë isha personalisht dhe politikisht e befasuar për të mirë kur ministri i Jashtëm spanjoll, Miguel Angel Moratinos, venditi që mban Presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, më dha një përgjigje të qartë në Komisionin për Marrëdhënie me jashtë më 4 shkurt 2010, mbi pyetjen time rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. Ai tha se duke lënë mënjanë faktin se Spanja nuk

e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur, Presidenca do të mbështesë të gjithë hapat e ndërmarrë për të sjellë banorët e këtij vendi sa më afër Bashkimit Evropian.

Me këtë mendim Presidenca evropiane ka ndërmarrë një qëndrim të qartë për mbështetje ndaj banoreve të Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës veçanërisht prejse liria e lëvizjes është një nga parimet kryesore të Bashkimit Evropian

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Verena Knaus

Njerëzit, natyrisht, po shtrëngohen në pyetje shumë të qarta: Si mund të ndodhë që Bashkimi Evropian na premtonte perspektivë evropiane, ne dëgjojmë vazhdimisht që jemi pjesë e Evropës, që do të bëhemi pjesë e saj, që Bashkimi Evropian po dërgon misionin e BE-së për sundim të ligjit, sepse beson në Kosovën dhe dëshiron që Kosova të jetë pjesë e Evropës, dhe në të njëjtën kohë nuk dëshiron që kosovarët të udhëtojnë as si turistë në Bashkimin Evropian? Ky është paradoks dhe shumë njerëz e konsideruan si të tillë.

Prandaj, rreth 50 milionë banorë nga Ballkani Perëndimor do të udhëtojnë pa vizë. Pse po frikësohet aq shumë Bashkimi Evropian nga 2 milionë kosovarë?

Kjo është çështja e vetme e përbashkët, e cila i ka preokupuar të gjithë qytetarët e rajonit. Kjo është çështja e udhëtimit të lirë, e ndjenjës së të qenit pjesë e Evropës dhe e ndjenjës së mosrefuzimit apo mospërfundimit nga hapësira të cilën e konsiderojmë Evropë dhe e izolimit në atë që quajmë Geto e Shengenit.





dhe gjithashtu një nxitje kryesore për qytetarët në rajon për të marrë pjesë dhe për të mbështetur integrimin evropian. Liria e lëvizjes gjithashtu përfaqëson një nxitje të rëndësishme që nuk duhet nënvlerësuar për përmirësimin e marrëdhënieve në rajon. Megjithatë, deri tani procesi i liberalizimit të vizave solli përçarje të tepërta e të panevojshme në rajon, dhe jo nxitje për bashkëpunim rajonal dhe ndërveprim mes qytetarëve të shteteve të ndryshme. Duke u mbështetur në një anketë të fundit të Gallupit www.gallup-monitor.eu 44 për qind e të anketuarve në Kosovë pranojnë se liberalizimi i vizave ka prezantuar përçarje të panevojshme të vendet e Ballkanit Perëndimor. Me rënien e regjimit Schengen për Serbinë, FYROM dhe Malin e Zi, pengesat për të udhëtuar për kosovarët veçse janë shtuar. Në këtë mënyrë Kosova është kthyer në një prej vendeve më të izoluara në botë (një studim i kohëve të fundit nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet ESI ka treguar se edhe afganët, për shembull, mund të udhëtojnë në më shumë vende pa vizë sesa kosovarët). Ky fakt veçse ka irrituar përçarjet që kanë ekzistuar më parë mes vendeve të rajonit, siç është mosnjohja e Kosovës nga Bosnjë-Hercegovina. Liria e lëvizjes është një nga parimet bazë të idesë evropiane, megjithatë,

procesi në vetvete i ka dy anë. Për shembull, përputhja me kërkesat teknike për procesin e liberalizimit të vizave mund të bjerë lehtë në konflikt me të drejtat e tjera të qytetarëve. Një rast të tillë paraqet zbatimi i marrëveshjeve të riatdhësitimit mes vendeve të BE-së dhe Kosovës. Edhe pse pjesëtarët e komunitetit rom ballafaqohen me kushte të mjerueshme sociale dhe ekonomike kur kthehen në Kosovë, riatdhësimi i romëve nga shtetet anëtare të BE-së në Kosovë ka vazhduar për gjatë viteve 2009 dhe 2010. Pas vizitës së tij në Kosovë në shkurt 2010, komisioneri për të drejtat e njeriut në Këshillin e Evropës, Thomas Hammarberg, ka kërkuar ndalimin e kthimit të romëve me forcë dhe evakuim të menjëhershëm të tyre nga kampet e kontaminuara me lëndë helmuese në veri të Mitrovicës. BE-ja ka investuar 5 milionë euro për ndërtimin e shtëpive të reja, duke përfshirë një klinike të vogël mjekësore, në jug të lumit Ibër, dhe është duke u përpjekur që të bindë njerëzit të rikthehen atje në mënyrë që të kenë mundësinë që njëherë e përgjithmonë të mbyllin ato kampe të kontaminuara me plumb. Autoritetet kosovare, sidomos ish-ministri i Brendshëm, Zenun Pajaziti, kanë filluar qysh vitin e kaluar të vendosin standardet e tyre (bazuar në njohuritë

mbi procesin e liberalizimit të vizave në vendet e tjera). Ata do të duhej të merreshin jo vetëm me pasaportat biometrike por edhe me çështje të tjera, të cilat janë të domosdoshme, për shembull, para se të lëshohen pasaportat biometrike, së pari duhet pasur regjistra të besueshëm civilë. Nga ana e Komisionit Evropian unë shpresoj të arrihet marrëveshje që Kosovës t'i jepet udhërrëfyesi para verës 2010, në mënyrë që qytetarët e saj të kenë një perspektivë për liberalizim, kurse Qeveria në Prishtinë ta ketë një rrugë të qartë se çfarë kërkohet nga ajo. Është tejet e nevojshme që të sigurohemi që procesi drejt liberalizimit të vizave të mos ketë efekte dytësore negative, por edhe në Kosovë, si në vendet e tjera të rajonit, të jetë një histori suksesi dhe se mbështetja masive e qytetarëve për integrimin në BE (sipas Ballkan-monitor.eu 88% e të anketuarve në Kosovë mendojnë se anëtarësimi në BE është një gjë e mirë, kjo është përqindja më e lartë në rajon) nuk do të kthehet në zhgënjim. Nga ana e Parlamentit Evropian qytetarët e Kosovës mund të sigurohen se kanë mbështetjen e plotë dhe të gjerë për liberalizimin e vizave.

(Autorja është deputete e Parlamentit Evropian dhe raportuese e PE-së për Kosovën)

KRITERET E QARTA, POR TRAJTIMI JO I BARABARTË I KOSOVËS

Augustin Palokaj



Në Bashkimin Evropian ekziston një gatishmëri që edhe qytetarët e Kosovës të mund të gëzonin në një të ardhme të pacaktuar mundësinë e udhëtimit pa viza në vendet e zonës së Schengenit. Mbështetja për këtë është në rritje sidomos në kohën kur vizat për udhëtime turistike me mundësi qëndrimi deri në 90 ditë janë hequr për shtetasit e Malit të zi, Maqedonisë dhe Serbisë, ndërsa Komisioni Evropian ka rekomanduar edhe heqjen e vizave për qytetarët e Shqipërisë dhe të Bosnjë-Hercegovinës, sapo këto dy shtete të përmbushin edhe një numër të kriterëve që ende nuk i kanë përmbushur në mënyrë të kënaqshme. Kjo do t'i lërë qytetarët e Kosovës të jenë të vetmit banorë të rajonit, të cilët nuk do të gëzojnë këtë mundësi. Rrethanat e tilla kanë ndikuar që madje edhe shtetet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të mos e kundërshtojnë idenë e dialogut të vizave.

Por statusi i Kosovës pritet, megjithatë nëse jo ta pengojë, atëherë dukshëm ta rëndojë procesin e liberalizimit të vizave. Për shkak se 5 nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian nuk e njohin pavarësinë e Kosovës në dokumentet e BE-së, as fjalët që shkruhen nuk lejohen që të sugjerojnë se Kosova trajtohet nga BE-ja sikur të ishte shtet. Zyrtarë të Bashkimit Evropian shpesh thonë se "substancia dhe qëllimi janë më të rëndësishme sesa forma" dhe sugjerojnë se, kur t'i përmbushë kriteret, Kosova do të mund të përfitojë po ashtu nga liberalizimi i vizave. Megjithatë, një shikim në formulimet që bëhen rreth Kosovës bën të qartë se Kosova nuk trajtohet njëlojt sikur që janë

trajtuar shtetet e tjera. Së pari, sa herë që përmendet çështja e heqjes së vizave, nuk përmenden terme si "udhërrëfyes" apo "dialog për liberalizim vizash" dhe si qëllim nuk thuhet "liberalizimi i vizave", por terme të kushtëzuara si "dialog që eventualisht mund të çojë në liberalizimin e vizave".

Disa vende anëtare të Bashkimit Evropian që nuk e njohin Kosovën si shtet, si dhe një numër i madh i deputetëve në Parlamentin Evropian nga këto shtete insistojnë madje edhe në detaje, siç është për shembull kërkesa që askund të mos thuhet "qytetarët e Kosovës", por "banorët e Kosovës" dhe që në vend të "liberalizimit të vizave" të thuhet "lehtësimi i vizave".

Me gjithë vështirësitë ligjore që dalin nga fakti i mosnjohjes nga të gjitha vendet anëtare, në BE besojnë se mund të gjendet një zgjidhje ligjore që Kosova të mos mbetet e izoluar në rajon dhe në BE në aspektin e lëvizjes së lirë të qytetarëve. Madje edhe ministra nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, siç është ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajcak, kanë thënë se "kur ekziston vullneti mund të gjendet edhe rruga, dhe në BE ka padyshim vullnet që askush të mos mbetet i izoluar, pra as kosovarët".

Pa marrë parasysh se si do të emërohen proceset që mund të çojnë në përfshirjen e Kosovës në liberalizimin e vizave me BE-në, kriteret do të jenë të qarta dhe përmbushja e tyre do të kërkohej në mënyrë rigoroze. Për Kosovën së pari, madje edhe para nisjes së procesit, është kërkuar që të ketë ose marrëveshje bilaterale me vendet e BE-së për riatdhësim, ose një ligj të Kosovës për riatdhësim,

sipas të cilit Kosova do të obligohej të pranonte të kthyerit nga secili vend i BE-së, ku ata qëndrojnë ilegalisht dhe u është refuzuar kërkesa për strehim politik apo ndodhen atje ilegalisht në ndonjë bazë tjetër. Pas kësaj Kosova duhet të ketë një ligj të duhur edhe për riintegrimin e të kthyerve dhe të dëshmojë se ka mekanizma për zbatimin e një ligji të tillë. Më pas, për shkak të sigurisë së dokumenteve, Kosova duhet të rregullojë sipas standardeve më të larta regjistrin civil dhe vetëm pas këtyre masave të nisë lëshimin e pasaportave biometrike. Komisioni Evropian madje ua ka tërhequr vërejtjen autoriteteve të Kosovës që të mos nisin lëshimin e pasaportave biometrike pa e rregulluar regjistrin civil.

Kriteri i sigurisë së dokumenteve është ndër kriteret kryesore në të cilat vendet e BE-së insistojnë. Dhe ky kriter nuk ka të bëjë vetëm me kualitetin e pasaportës biometrike, por me të gjitha dokumentet që kërkohen për marrjen e një pasaporte të tillë. Për këtë arsye si kriter edhe për dialogun e liberalizimit të vizave është edhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo kërkesë është për të parandaluar që në të ardhmen, kur Kosovës t'i hiqen vizat, ndonjë shtetas i ndonjë vendi të tretë të mos ketë mundësi që përmes korrupsionit të zyrtarëve të mundësojë pasaportën e këtij vendi me të cilën do të mund të udhëtonte pastaj në BE. Ekspertët e Komisionit Evropian dhe të vendeve anëtare do të mbikëqyrin edhe mënyrën e lëshimit të certifikatave të lindjes, atyre të nën-shtetësisë dhe dokumenteve të tjera.

Gjendja sociale në Kosovë, sundimi i rendit dhe i ligjit, respektimi dhe mbrojtja e

të drejtave të pakicave, po ashtu janë ndër kritere të cilat kërkohen nga Bashkimi Evropian. Dikush do të pyeste se çfarë ka të bëjë çështja e të drejtave të pakicave me liberalizimin e vizave, por përgjigjja në këtë pyetje është shumë logjike. Vendet e BE-së duan të sigurohen që askush nga Kosova të mos mund të ketë arsye politike për të kërkuar azil në vendet e BE-së për shkak se në Kosovë nuk u garantohen të drejtat elementare. Pos kritereve të qarta, siç janë siguria e dokumenteve, migrimi ilegal, riintegrimi, ligji për azilin dhe marrëveshjet e riatdhesisimit, rendi publik, siguria e përgjithshme dhe marrëdhëniet me jashtë, garancitë politiko-ekonomike, aspektet civile dhe juridike dhe të tjerat, BE-ja kërkon edhe një fushatë të informimit të publikut që, edhe kur të hiqen vizat, kjo nuk do të thotë se qytetarët e Kosovës do të mund të shkonin për të punuar në vendet e Bashkimit Evropian. Në një fushatë të tillë Bashkimi Evropian ka insistuar në rastin e Shqipërisë dhe të Bosnjë-Hercegovinës. Një lloj alarmi për këtë ka qenë edhe rasti i rritjes dramatike të numrit të qytetarëve nga Maqedonia dhe Serbia (për të cilët organet e vendeve të BE-së pohojnë se kanë qenë shumica me përkatësi etnike shqiptare) që në fillim të vitit 2010, pra menjëherë pas hyrjes në fuqi të heqjes së vizave, të cilët kanë ardhur në disa vende të BE-së për të kërkuar strehim. Shumë vende të BE-së janë shqetësuar së pari me këtë dukuri, por në fund u ka shërbyer edhe si shembull që të dëshmohej se liberalizimi i vizave është me përfitim të dyanshëm; një njërën anë të qytetarëve për të udhëtuar, por, në anën tjetër, edhe të vendeve të BE-së, të cilat kanë mundur pa problem t'i kthenin nga kanë ardhur.

Në rastin e Kosovës BE-ja nuk pranon të japë afate se kur mund të ndodhë hapi në procesin e liberalizimit të vizave. Por, bazuar në përvojën e vendeve të tjera, pritët që kjo të zgjasë mes tri deri në pesë vjet, e deri në hyrjen në fuqi të ndonjë vendimi eventual.

(Autori është korrespondent i "Kohës Ditore" nga Brukseli)

Citate nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

A duhet Bashkimi Evropian t'ia ofrojë Kosovës udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave?

Aleksandra Stiglmayer:

Kosova duhet ta ketë udhëzuesin, sepse brenda disa muajsh vetëm qytetarët e Kosovës nuk do të mund të udhëtojnë pa viza, dhe kështu Kosova do të jetë plotësisht e izoluar në raport me vendet fqinje. Situata atje tashmë është e mjerë, sepse aktualisht kosovarët mund të udhëtojnë vetëm në pesë shtete pa viza.



Renzo Daviddi:

Nuk mendoj se rruga deri tek udhëzuesi është e gjatë.

Augustin Palokaj:

Kosova pa dyshim se duhet ta marrë udhërrëfyesin nga Bashkimi Evropian.

Tanja Fajon:

Mendoj se është e rëndësishme që Kosova ta ketë udhëzuesin sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të fillojë të punojë në këtë drejtim, si dhe të ketë perspektivë të qartë, sepse përpara e pret një rrugë e gjatë.



Ulrike Lunacek:

Unë kam bërë presion dhe kam biseduar me të gjithë zyrtarët e Komisionit dhe u kam thënë: "Ju lutem, hartojeni udhëzuesin para verës, tregojni autoriteteve të Kosovës çka duhet të bëjnë hap pas hapi, pastaj kjo do të



jetë në duart e Kosovës, por para se ta kenë datën specifike apo standardet specifike!" Por, mendoj se BE-ja po zhvillohet në një bashkim të shteteve, ku ksenofobia është mjaft e përhapur, ku ka racizëm ndaj të huajve që vijnë kryesisht nga vendet e jugut dhe të cilët mund të kenë lëkurë më të zezë. Kjo është arsyeja pse mendoj se nuk duhet të ketë marrëveshje të riatdhesisimit.

Stefan Fule:

Pajtohem me ju që kjo rrugë duhet të jetë plotësisht e qartë, sepse kjo është njëkohësisht çështje tejet politike, por edhe teknike.


Rada Trajković:

Prandaj, mendoj që edhe hapësirës së Kosovës dhe Metohisë duhet t'i jepet shansi që ta rregullojë mundësinë e lirisë së lëvizjes, duke filluar të punojë në atë, që në fakt është përgjigje e Ministrisë së Punëve të Brendshme ndaj kësaj sfide.



Eduard Kukan:

Nuk e di saktësisht nëse kjo është pengesë e madhe, por përfundimisht është pengesë. Edhe pse të gjithë nuk e kanë njohur Kosovën, përfshirë këtu edhe anëtarët e Parlamentit nga pesë vendet, kjo çështje duhet të adresohet pa e marrë parasysh statusin zyrtar të Kosovës, sepse kjo ka të bëjë me popullin e saj dhe popullit të Kosovës nuk duhet t'i mohohet kjo e drejtë.



LIBERALIZIMI I VIZAVE DHE KOSOVA¹

Renzo Daviddi



Liberalizimi i vizave është temë e rëndësishme në Ballkanin Perëndimor. Ajo kërkon vëmendjen si të liderëve politikë po ashtu edhe të qytetarëve të thjeshtë. Në të vërtetë, një ndër objektivat kryesore të liberalizimit të vizave është që të tregojë përfitime të prekshme që rrjedhin nga procesi i pranimit në BE për njerëzit e rajonit. Në këtë kontekst unë e mirëpres interesimin dhe iniciativat proaktive që shoqëria civile në Kosovë është duke treguar në këtë drejtim.

Liberalizimi i vizave është prioritet politik për Qeverinë e Kosovës dhe një perspektivë domethënëse për qytetarët e saj. Liberalizimi i vizave është gjithashtu një instrument i rëndësishëm

i politikës së BE-së në Kosovë dhe çështje mjaft konkrete për vendet anëtare të BE-së, të cilat drejtpërdrejt merren me implikimet e migracionit që rrjedhin nga liberalizimi i vizave.

Përderisa në Kosovë ka pritje të mëdha, njëkohësisht ekziston edhe një angazhim i madh nga Bashkimi Evropian, i cili njëzëri pranoi se Kosova përfundimisht duhet të përfitojë nga liberalizimi i vizave.

Disa mund të pyesin nëse "çështja e statusit" mund të pengojë Kosovën në rrugën e saj drejt qëllimit të udhëtimit pa viza. Është e rëndësishme që të theksohet se të gjitha shtetet anëtare të BE-së pajtohen në perspektivën evropiane të Kosovës, ku liberalizimi i

vizave është një nga hapat e parë në këtë proces.

Shumë në Kosovë sugjerojnë që Kosova duhet të pranojë "një udhërrëfyes për liberalizimin e vizave" shpejt e shpejt, pasi qytetarët e Kosovës duhet lejuar që të udhëtojnë pa viza. Megjithatë, procesi i ka hapat e vet logjikë, të cilët duhet respektuar. Thjesht, Kosova akoma nuk e ka arritur fazën në të cilën ajo mund të marrë, ashtu siç Komisioni në tetor e quajti atë, "strategjinë për liberalizimin e vizave".

Në rajon hapi i parë ishte krijimi i një regjimi funksional të ripranimit. Kosova gjithashtu duhet të krijojë një regjim të tillë të riatdhesimit. Prandaj, duhet të miratojë një ligj mbi riatdhesimin, i cili do të përcaktojë procedurat se si të adresohen kërkesat nga shtetet anëtare të BE-së dhe çfarë të bëhet në praktikë. Megjithatë, miratimi i ligjit nuk mjafton. Kosova jo vetëm që duhet të ketë kapacitetet e duhura administrative për t'u marrë me kërkesat e riatdhesimit, të adresuara nga shtetet e treta në Kosovë, por gjithashtu duhet të ketë kapacitetet logjistike, sociale dhe ekonomike për t'u përballur me personat e riatdhesuar, duke përfshirë këtu edhe komunitetet jo shumicë dhe këtë duhet bërë në një mënyrë të qëndrueshme. Aktualisht, Kosova përballlet me sfida në këtë fushë dhe duhet të rrisë përpjekjet e saj. Përgjegjësia e BE-së është të sigurojë që liberalizimi i vizave nuk do të çojë në

Në komunikatën e saj për Kosovën në tetor 2010 (Kosova-duke përmbushur perspektivën e saj evropiane); Komisioni Evropian ka deklaruar se:

Qytetarët e Kosovës duhet të ndajnë më shumë nga përfitimet e përafrimit me BE-në, duke përfshirë edhe mundësinë e udhëtimit pa viza për në BE. Kjo është e mundur vetëm nëse Kosova mund të sigurojë që reformat e duhura janë zbatuar dhe rregullat dhe procedurat respektohen në mënyrë të tillë që minimizojnë rreziqet që lidhen me sigurinë për shtetet anëtare të BE-së. Pika fillestare për këto reforma është funksionimi i duhur i marrëveshjeve të riatdhesimit. Kosova ka nevojë të përshtatë legjislacionin e saj, të forcojë kapacitetet administrative që të procedojë kërkesat e riatdhesimit dhe të zbatojë një strategji efektive të riintegrit. Ajo gjithashtu ka nevojë të rrisë sigurinë e kufijve të saj dhe të sigurojë menaxhimin e regjistrave civilë dhe dhënien e dokumenteve.

Komisioni propozon që të shkohet përpara me një qasje të strukturuar për të sjellë qytetarët e Kosovës më afër BE-së nëpërmjet një dialogu të vizave me perspektivën e liberalizimit eventual të vizave, atëherë kur reformat e nevojshme do të jenë ndërmarrë.

Në fund të vitit 2010, Këshilli i BE-së deklaroi që nëse të gjitha kushtet plotësohen, Kosova duhet të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit eventual të vizave. Kjo është deklaruar nga 27 shtete anëtare të BE-së, pa paragjykuar pozicionet e vendeve anëtare mbi statusin e Kosovës.

Këshilli thekson se Kosova duhet të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit eventual të vizave kur të gjitha kushtet të jenë plotësuar dhe e fton Komisionin për të ecur përpara me një qasje të strukturuar për të sjellë popullin e Kosovës më afër BE-së.

¹ Nën Rezolutën 1244/1999.

² Pa paragjykuar pozicionet e vendeve anëtare mbi statusin

flukse migrimi që do të ishin të dëmshme për shtetet anëtare të BE-së, por edhe për Kosovën.

Sa i përket lehtësimit të vizave, i cili zakonisht shoqëron riatdhesimin, është e rëndësishme të përmendet që shumica e vendeve anëtare të BE-së e zbatojnë këtë rast pas rasti mbi bazën e fleksibilitetit të lejuar nga legjislacioni i BE-së. Kjo në praktikë do të thotë se shumë qytetarë nga Kosova mund të marrin vizë duke paguar taksë të reduktuar apo për kategori të caktuara të mos e paguajë atë fare.

Hapi i ardhshëm – strategjia e shoqëruar me dialogun për liberalizimin e vizave – mund të vijë sapo Komisioni dhe shtetet anëtare konsiderojnë që regjimi i riatdhesimit funksionon në mënyrë të kënaqshme. Kjo do të vazhdojë të monitorohet edhe gjatë dialogut dhe është pjesë e strategjisë. Njerëzit në Kosovë dhe liderët politikë të tyre duhet të kenë pritje realiste. Raporti i progresit i vitit 2009 thekson që Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit në të gjitha katër shtyllat e strategjisë (siguria e dokumenteve, migrimi dhe funksionimi i menaxhimit të integruar të kufijve, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave themelore për të gjithë banorët e Kosovës). Kosova duhet të tregojë rezultate të prekshme

në të gjitha këto fusha. Përkushtimi politik duhet shoqëruar me angazhim të fortë teknik dhe koordinim të plotë ndërministror/agjencish. Nismat e fundit të ndërmarra në këtë drejtim nga Ministria e Punëve të Brendshme janë për t'u lavdëruar.

Në dhjetor 2009, u bë e qartë që puna e rëndë dhe zbatimi i reformave shpërblehen. Tri vende – Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia – arritën të përmbushin kërkesat për liberalizimin e vizave. Ky vendim i parapriu një numri të vlerësimeve të mëhershme në terren, shoqëruar me rekomandime, raundeve të diskutimeve teknike dhe politike me vendet e cekura, si dhe me shtetet anëtare.

Do të doja që të shfrytëzoja këtë mundësi për të nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile në këtë proces. Në procesin e liberalizimit të vizave Kosova duhet të japë për vetveten. Udhëheqësit politikë vendorë duhet të vëzhgohen se si e kanë perceptuar agjendën e reformave për në BE. Nëse arrihen rezultate të prekshme, unë jam i bindur që BE-ja do të jetë në pozitë të avancojë në fazën e ardhshme të procesit dhe në fund të hapë dyert për qytetarët e Kosovës. Historia e zgjerimit tregon se çdo valë e zgjerimit të BE-së kishte modele të veçanta, prandaj edhe ishte trajtuar ndryshe nga BE-ja. Në mënyrë të ngjashme, çdo dialog për viza është ndryshe dhe adoptuar në varësi të rrethanave specifike, edhe pse korniza e përdorur është e njëjtë (riatdhesimi, riintegrimi, strategjia, dialogu për viza dhe pranimi).

Disa mund të pyesin: Çka do të thotë liberalizimi i vizave në praktikë? Liberalizimi i vizave nënkupton udhëtim pa viza për një periudhë afatshkurtër në zonën e ashtuquajtur Schengen. Zona e Schengenit përfshin territoret e 25 vendeve evropiane – 22 anëtare të BE-së dhe Norvegjia, Islanda dhe Zvicra. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë pjesë e zonës Schengen. Bullgaria, Qiproja dhe Rumania ende nuk e kanë zbatuar plotësisht tërë *acquis* për

Schengen, por këto vende gjithashtu do të integrohen në të ardhmen në këtë zonë. Programi "waiver" për viza aplikohet gjithashtu për këto vende (Rregullorja 539/2001).

Liberalizimi i vizave lejon udhëtimin pa vizë vetëm deri në 90 ditë (çdo gjashtë muaj). Për udhëtime më të gjata duhet aplikuar për një vizë për qëndrim më të gjatë në konsullatën e shtetit të lartcekur. Liberalizimi i vizave vlen vetëm për të udhëtuar. Ai nuk jep të drejtën për të punuar apo punësuar. Nëse ndonjëri e ka ndërmend të vijë në zonën Schengen për të kryer një aktivitet me pagesë, ai prapë duhet të aplikojë për vizë apo leje pune. Liberalizimi i vizave nuk do të thotë se udhëtarët nuk do të refuzohen në kufi. Në fakt, për shtetasit e vendit të tretë viza është njëri nga kushtet për kalimin e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian. Autoritetet kufitare të vendeve Schengen kanë të drejtën vendimtare mbi hyrjen. Udhëtarëve mund t'u kërkohej që të japin garanci të caktuara. Prandaj, edhe pas liberalizimit të vizave, kushtet e tjera të hyrjes (siç janë mjetet e jetesës së mjaftueshme që lejojnë mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe kthimit) për të gjithë shtetasit e vendeve të treta që udhëtojnë në zonën Schengen mbesin në fuqi.

Për të përmbyllur, udhëtimi pa viza me siguri do të provojë të jetë një përfitim i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Unë jam gjithashtu i bindur se kjo do të sjellë përfitime ekonomike dhe zhvillim të mëtejshëm të kontakteve ndërnjerëzore. Do të jetë një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Megjithatë, rruga për të arritur atje është plotë sfida dhe Kosova është vetëm në fillim të procesit. Komisioni Evropian do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Kosovës në këtë drejtim. Unë jam krenar që me ekipin tim mund të kontribuoj në këto përpjekje.

(Autori është udhëheqës i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë)

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Rada Trajkoviç:

... ekzistojnë shumë zgjidhje kreative, të cilat nuk duhet ta vënë në pikëpyetje cilësinë e jetës së banorëve të Kosovës dhe atë që quhet liri e lëvizjes.

Edhe Bashkimi Evropian me gjasë e kupton rëndësinë e lirisë së lëvizjes edhe si mënyrë për tejkalimin e konflikteve të tyre të përditshme. Bashkimi Evropian, i cili është në fakt projekti më i madh paqësor, me segregacionin e Kosovës dhe Metohisë, nuk bën asgjë që mund të jetë në funksion të stabilizimit të rajonit, por, përkundrazi, po punon për diçka që nuk do të sjellë normalizim të jetës apo ndjenjën në mesin e njerëzve që edhe ata kanë fituar të drejtën të funksionojnë si të gjithë të tjerët në rajon.

HOLLËSI DHE IMTËSI PARA LËVIZJES SË LIRË

Enver Robelli



Dikur ishte ndryshe. Udhëtimet nga Ballkani drejt Evropës Perëndimore planifikoheshin shpejt, pothuaj në mënyrë spontane. Një valixhe e mbushur me rroba, një 500 marka gjermane dhe pasaporta e kuqe jugosllave në xhep mjaftonin për t'u nisur drejt stacionit të trenit në Fushë-Kosovë, në Ferizaj apo në Bujanoc. Sot këto stacione hekurudhore janë në gjendje të mjerë, gati asnjë gjurmë nuk ka mbetur nga fama e dikurshme, kur trenat që niseshin në Greqi përshkonin gjithë Ballkanin në rrugë drejt Evropës. Këta trena ndalonin edhe në Fushë-Kosovë, në Ferizaj apo në Bujanoc dhe në vagonët e vjetër hipnin qindra e mijëra shqiptarë, serbë, romë. Në një kohë pothuaj të gjitha rrugët të çonin në qytetet kufitare të Italisë, sidomos në Trieste, ku shtetasit e Jugosllavisë bënin pazaret fitimprurëse. Blinin një grumbull xhinsa dhe i ofronin për shitje nëpër pazaret e Prishtinës, Pejës e Gjilanit. Fitimet mjaftonin për të blerë artikuj ushqimorë dhe për të pirë ndonjë birra në kafehanat e lagjes. Disa kosovarë të tjerë e zbulonin Lindjen, shkonin në Poloni e Çekosllovakë, sepse ishin të bindur se atje ishte një botë hedoniste. Shpesh nuk zhgënjeheshin.

Kjo botë ka perënduar, ajo u kujtohet vetëm gjeneratës së kosovarëve të moshës mbi 50-vjeçare. Me shkatërrimin e Jugosllavisë në fillim të viteve 90-të, për shumicën e popujve të Ballkanit mori fund edhe mundësia e udhëtimit pa viza. Nga frika e vërshimit të Evropës Perëndimore nga mijëra njerëz, kryesisht viktimat e luftërave, shtetet evropiane mbyllën kufijtë. Shqiptarët e Kosovës, boshnjakët, shtetasit e Maqedonisë, malazezët dhe

serbët e humbën një pjesë të rëndësishme të lirisë – lirinë e lëvizjes. Janë mbushur gati 20 vjet qëkur regjimi i ashpër i vizave kufizon dukshëm lirinë e njerëzve në Ballkan, me përjashtim të kroatëve dhe sllovenëve, të cilët nuk u detyruan të pajisen me viza për të udhëtuar në Evropë. Radhët e gjata të njerëzve që presin para ambasadave dhe përfaqësive konsullore për të marrë një vizë janë shndërruar në sinonim të pritjes së një rajoni për t'u integruar në BE, për të qenë pjesë e botës normale. Regjimi i vizave i ka goditur në radhë të parë të rinjtë, ata që mes moshës 15 dhe 25 vjeçare do të duhej të zbulonin botën, të zbulonin kulturat të tjera dhe modele të tjera të zhvillimit shoqëror. Vizat kanë pamundësuar shkëmbimet mes sistemeve të shkollimit të lartë, shumë profesorë universitarë dhe akademikë tashmë dy decaie nuk kanë kontakte me kolegët e tyre në Evropë. Pamundësia e lëvizjes pengon edhe zhvillimin ekonomik. Një tregtar apo pronar fabrike në Ballkan duhet të kalojë barrierën e lartë të vizës për të udhëtuar në vendet e Evropës Perëndimore me qëllim të krijimit të kontakteve me partnerë afaristë. Të vetmit që e kanë hequr barrierën e vizave janë kriminelët e Ballkanit. Përmes bashkëpunimit të krimit të organizuar transnacional ata kanë gjetur mundësi për të kapërcyer të gjithë kufijtë. Kanë pësuar, ndërkaq, të rinjtë, siç u përmend më lart. Për shembull, deri para liberalizimit të vizave në fund të dhjetorit 2009, rreth 70 për qind e të rinjve në Serbi kurrë nuk kanë pasur mundësinë të vizitonin ndonjë shtet tjetër. Supozohet se një gjendje e tillë mbretëron edhe në Kosovë.

Grupe të shoqërisë civile kanë bërë presion ndaj BE-së prej vitesh që, më në fund, të heqin vizat dhe, në këtë mënyrë, qytetarëve të Ballkanit t'u kthejnë një pjesë të rëndësishme të lirisë – lirinë e lëvizjes. Për të arritur këtë liri vendet e Ballkanit duhet të plotësojnë një katalog kushtesh të vendosura nga BE-ja. Ndër kushtet kryesore numërohen kontrolli i rreptë i kufijve, në mënyrë që të pengohet shkuarja e refugjatëve në Evropë nga vendet e Lindjes së Afërt dhe të Azisë (kurdëve, irakianëve, afganëve etj.). Për të siguruar këtë nevojiten trupa policore të specializuara dhe të pajisura me mjete teknike, siç janë aparatet për vëzhgim gjatë natës, patrullat mobile për reagim të shpejtë. Kush tjetër i rëndësishëm është një sistem funksional i trajtimit dhe akomodimit të refugjatëve të kapur në kufi, të cilët duhet t'i nënshtrohen procedurës së azilërkimit, shqyrtimit dhe pranimi apo dëbimit në vendet prejardhëse. Kushti i radhës është pajisja e qytetarëve me pasaporta biometrike, të cilat me të dhënat e tyre që përmbajnë janë burim i rëndësishëm informacioni për policinë e vendeve të Schengenit. Gjithashtu shtetet e Ballkanit që synojnë liberalizimin e vizave duhet të lidhin marrëveshje për pranimin e shtetasve të tyre, të cilët kërkojnë azil në vendet e Evropës Perëndimore ose qëndrojnë ilegalisht atje, për shembull nëse në shtetet e BE-së qëndrojnë më shumë se tre muaj. Paralelisht me këto masa shtetet duhet të organizojnë fushata publike për informimin e qytetarëve mbi kushtet e lirisë së lëvizjes në vendet e Schengenit. Qytetarët duhet ta kuptojnë se heqja e vizave nuk domethënë se ata mund të punojnë në

vendet e BE-së ose të qëndrojnë sa të duan në territoret e këtyre shteteve.

Në fillim të këtij viti, pas liberalizimit të vizave për qytetarët e Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, grupe kriminale që merren me kontrabandën e njerëzve në viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës plasuan gënjeshtër se heqja e vizave mundëson edhe fitimin e statusit të azilantit në Belgjikë dhe në disa vende nordike, siç është Suedia. Për pasojë disa mijëra shqiptarë nga Maqedonia dhe Lugina e Preshevës u vërsulën drejt Evropës. Nga disa fshatra të rrethit të Kumanovës për çdo ditë nisehim dhjetëra autobusë drejt Belgjikës. Ky zhvillim shkaktoi shqetësime në Bruksel dhe politikanët e BE-së kërkuan nga Qeveria në Shkup që t'i njoftojë më mirë qytetarët e saj se çfarë domethënë heqja e vizave. Njëkohësisht Qeveria e Belgjikës organizoi kthimin e atyre personave që kishin keqpërdorur liberalizimin e vizave për të kërkuar azil.

Nga të gjitha këto duhet të mësojnë edhe autoritetet e Kosovës. Para liberalizimit të vizave BE-ja kërkon plotësimin e shumë kushteve, pra duhet të kryhen shumë detyra të imëta. Për fat të keq, autoritetet e Kosovës me vite të tëra nuk kanë bërë pothuaj asgjë për plotësimin e kushteve për heqjen e vizave. Kosova është vendi i vetëm në rajon që ende nuk lëshon pasaporta biometrike. Tek para pak kohësh Ministria e Brendshme ka filluar të nënshkruajë marrëveshje me shtetet e BE-së për kthimin e refugjatëve. Kontrolli i kufijve të Kosovës ende nuk është i garantuar

– në veri të vendit për shkak të pranisë së strukturave ilegale serbe, në pjesët e tjera të Kosovës, ndërkaq, për shkak të joefikasitetit të policisë, e cila në këtë drejtim ende është e papërvollë dhe pa motiv për të kryer punën për shkak të rrogave tepër të ulëta. Si pengesë për liberalizimin e vizave paraqitet, gjithsesi, edhe imazhi i keq i Kosovës në opinionin evropian. Kosova, për fatin e keq të qytetarëve të saj, ende konsiderohet si qendër e trafikimit të qenieve njerëzore, e krimit të organizuar dhe si oazë për kontrabandën e drogës drejt Evropës. Shpeshherë raportet në mediet evropiane për Kosovën janë të ekzagjeruara, shpesh Kosova në mënyrë paushalle degradohet si vatër e krimit që paraqet rrezik për Evropën. Raportet për korrupsionin endemik të strukturave qeveritare gjithashtu e dëmtojnë rëndë imazhin e Kosovës. Dënimi i grupeve të dilerëve të drogës nga Kosova në vendet e Evropës jo rrallë dominon kronikat e zeza të medieve. Me një fjalë: imazhi i Kosovës është aq i keq sa është bërë pengesë për liberalizimin e vizave dhe për integrimin e vendit në BE. Situata e paqartë e Kosovës në arenën ndërkombëtare për shkak të refuzimit të pesë vendeve të BE-së për të pranuar pavarësinë e vendit është një pengesë tjetër. Autoritetet e Kosovës gjenden para detyrave të mëdha. Ato duhet të plotësojnë në mënyrë rigoroz kushtet e BE-së për heqjen e vizave. Në këtë drejtimin kërkohet krijimi i një administrate efikase, e cila do të jetë në funksion të garantimit të sigurisë së plotë

dhe bashkëpunuese me organet policore dhe gjyqësore të vendeve të BE-së. Administrata e tanishme e Kosovës ashiqare nuk është në gjendje të kryejë këto kërkesa të BE-së. Shtyrja e disahershme e procesit për lëshimin e pasaportave biometrike është një dëshmi e radhës për joseriozitetin e autoriteteve shtetërore të Kosovës. Së fundi, krerë të Ministrisë së Brendshme kanë thënë se pasaportat biometrike të Kosovës do të kushtojnë rreth 50 euro – një çmim ky ndër më të shtrenjtë në rajon. Sa për krahasim: Në Serbi pasaporta biometrike kushton rreth 20 euro. Pak më të larta janë çmimet në vendet e tjera të rajonit, por larg çmimit të paralajmëruar nga MPB-ja e Kosovës. Kur BE-ja, në fund të dhjetorit 2009, vendosi t'ua hiqte vizat shtetasve të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në Bosnjë, në Kosovë dhe në Shqipëri nga qarqe të caktuara u dëgjuan zëra se BE-ja këtë e kishte bërë për shkak të averzionit që ka ndaj popullsisë myslimane në tri shtetet e përmendura. Në Bosnjë zyrtarë të bashkësisë islame me ton polemik e quajtën refuzimin e BE-së për liberalizim të vizave një "fata morgana antimuslimane". Akuzat e tilla nuk janë të përshtatshme për të ecur përpara. Nga Kosova, Shqipëria dhe Bosnja kërkohet plotësimi i kushteve, të cilat u përmendën më lart. Së fundi, Bosnja dhe Shqipëria kanë bërë hapa seriozë drejt liberalizimit të vizave. Për këtë arsye Brukseli ka propozuar heqjen e vizave. Mbetet të shihet nëse edhe Qeveria e Kosovës në muajt e ardhshëm do të punojë me përkushtim dhe seriozitet në plotësimin e kushteve. Për të arritur liberalizimin e vizave autoritetet e Kosovës duhet të bashkëpunojnë ngushtë jo vetëm me strukturat përkatëse të BE-së, por, njëkohësisht, duhet të llobojnë te politikanët prokosovarë në BE që këtë proces ta mbështesin publikisht. Një gjë e tillë nuk do të jetë e lehtë, sepse numri i atyre politikanëve evropianë që janë të gatshëm të angazhohen për Kosovën është gjithnjë e më i vogël për shkak të keqpeverisjes në Kosovë.

(Autori është korrespondent për Evropën Juglindore i gazetës gjermane "Süddeutsche Zeitung" dhe i të përditshmes zvicerane "Tages Anzeiger")



PSE KA RËNDËSI LIBERALIZIMI I VIZAVE DHE PSE TANI?

Verena Knaus



Nëse ekziston një çështje që provokon dhe sjell reforma mbresëlënëse dhe që me të vërtetë konfirmon perspektivë evropiane për vendet e Ballkanit, atëherë ky është procesi i liberalizimit të vizave, proces që po ndodh kohëve të fundit. Pas vendimit të BE-së në fillim të vitit 2008, që ofroi premtimin se sapo vendet e Ballkanit t'i përmbushin disa prej reformave më të vështira, qytetarët e tyre do ta kenë privilegjin e udhëtimit pa viza, besueshmëria e BE-së në rajon është rritur në mënyrë të papërshkrueshme.

Fakti që qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës, Serbisë, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Kosovës kishin nevojë për vizë, në mënyrë që të udhëtonin në vendet Schengen, i ka zbehur për shumë vjet marrëdhëniet dhe i ka bërë qytetarët e këtyre vendeve të ndihen të refuzuar dhe të padëshiruar. Gjithashtu, dukej shumë paradoksale që përderisa këtyre vendeve u thuhej që e ardhmja e tyre qëndron në Evropë, qytetarët e tyre nuk ishin të mirëpritur as si turistë. Përpara luftërave në fillim të viteve '90, qytetarët e ish- Jugosllavisë nuk kishin asnjë pengesë udhëtimi për sa u përket vizave: studentët, biznesmenët ose artistët thjesht mund të hipnin në një tren dhe të mbërrinin në Vjenë ose në Muni të nesërmen. Liria e udhëtimit pa shqetësimin konstant për të marrë një vizë në mënyrë të kushtueshme i bëri ata të ndihen pjesë e Evropës.

E ardhmja e rifitimit të asaj lirie për të udhëtuar ka qenë një çështje që ka prekur çdo qytetar të këtij rajoni, pavarësisht origjinës së tij etnike apo pikëpamjeve politike. Duke u kthyer

mbropa në kohë në vitin 2003, në Samitin e Selanikut në Greqi BE-ja premtoi një heqje eventuale të regjimit të vizave. Por, për shumë vjet asgjë e madhe nuk ndodhi; dhe ky më tepër dukej si një premtim bosh. Në vitin 2006, si përgjigje për t'i përmbyllur marrëveshjet e riatdhesimit, që rregullonin detyrimet e vendeve për të pranuar prapa çdo qytetar të tyre që jetonte në mënyrë të paligjshme në BE, të gjitha vendeve, përveç Kosovës, iu ofrua lehtësimi i vizave. Në praktikë, sido që të jetë, lehtësimi i vizave ndryshoi shumë pak gjë. Zvogëlimi i çmimit të një vize Schengen nga 60 në 35 euro e thjeshtësoi numrin e dokumenteve të kërkuara dhe e bëri më të lehtë për disa kategori njerëzish për të marrë një vizë Schengen. Por, përballë dhe i madh, muri Schengen qëndronte po aty.

Ishte mbi të gjitha Deklarata e Pavarësisë së Kosovës ajo që e provokoi vendimin e BE-së për të ofruar lehtësimin e vizave për Serbinë në janar 2008. Në momentin që Franco Frattini, komisioner për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në atë kohë, i kishte ofruar Serbisë një proces që do të çonte në udhëtim pa viza, kjo nuk mund t'u refuzohej më vendeve të tjera të rajonit. Në pranverë të vitit 2008, të gjitha vendeve, përveç Kosovës, iu ofrua i ashtuquajtur "Udhërrëfyes", që jepte me detaje mbi 50 reforma dhe standarde të qarta që secili shtet duhej t'i përmbushte si parakusht për t'u lejuar udhëtim pa viza. Këto reforma lëvizën nga çështje shumë teknike, si prezantimi i pasaportave biometrike të

lexueshme nga makineritë moderne, deri te ligjet mbi mbrojtjen e të dhënave, një sërë strategjish e konventash, përmirësimi i bashkëpunimit policor e gjyqësor me BE-në, politikat e kufirit dhe migracionit, sikurse edhe çështje më të përgjithshme, si luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Duke ua vënë përpara një agjendë me reforma të detyrueshme për ta plotësuar, procesi i udhërrëfyesit të vizave u kërkonte vendeve ta ndryshonin menaxhimin e kufijve të tyre, politikat e migracionit dhe sigurinë e dokumenteve nga këmbët te koka; duke adresuar shqetësimin personal të BE-së në fushën e krimit të organizuar dhe migrimit, njëkohësisht procesi i udhërrëfyesit krijoi një situatë ku të dyja palët dilnin fituese.

Vendeve u ishte bërë më se e qartë se çfarë kërkohej nga to në kuptimin e reformave për sundimin e ligjit, dhe si kundërpërgjigje, u ofrohej një shpërblim: udhëtim pa viza. Në këtë mënyrë, publiku dhe organizatat e shoqërisë civile në secilin vend patën mundësi të ushtronin presion në qeveritë e tyre, në mënyrë që këto të fundit t'i plotësonin

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Zenun Pajaziti:

Le të merren statistikak në Kosovë dhe le të shihet qarkullimi i qytetarëve nëpër vendet e BE-së dhe të shihet që në Kosovë, për shkak se kemi edhe më herët përvojë ku qytetarët tanë punojnë jashtë në vendet e Perëndimit, kohëve të fundit kërkesat më të mëdha për të dalë jashtë janë të gjeneratës së re për studime, vizita të punës, biznese të ndryshme.



reformat e kërkuara. Si rezultat, që nga dhjetori 2009, qytetarët e Malit të Zi, Maqedonisë, dhe Serbisë shijuan udhëtim të lirë në njërën anë, me Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën në pritje të kishin të njëjtin fat ne muajt e ardhshëm në anën tjetër. Kjo ngjarje e përmirësoi fuqinë e butë të BE-së në rajon dhe forcoi besueshmërinë në të. Po çfarë për Kosovën? Deri tani Kosova është lënë plotësisht jashtë këtij procesi. Kosova është i vetmi vend në rajon, që ende nuk i është ofruar udhërrëfyesi, dhe qytetarët e saj do të jenë të vetmit në rajon që nuk do të shijojnë udhëtim pa viza në vitin 2011. Kosova mbetet vendi më i izoluar në botë. Natyrisht, qytetarët e Kosovës me të drejtë pyesin: "Po ne?"

Në rastin e Kosovës, kjo duket një paradoks i veçantë, duke marrë parasysh se sa shumë ka investuar BE-ja tashme financiarisht dhe politikisht, dhe duke marrë parasysh që BE-ja është vetë e pranishme në Kosovë me një kontingjent prej 2.500 pjesëtarësh, me një mision të fortë për Sundimin e Ligjit (EULEX), gjoja për ta ndihmuar Kosovën dhe institucionet e saj në këtë drejtim. Në kundërshtim me atë që shumica besojnë, procesi i vizave mundet të jetë tërësisht neutral në lidhje me statusin.

Fakti që asnjë nga shtetet anëtare të BE-se nuk e ka njohur zyrtarisht Tajvanin, nuk e ka penguar BE-në që ta fillojë dialogun me Tajvanin për liberalizim të vizave. Me fjalë të tjera, fakti që 5 vende anëtare të BE-së akoma nuk e kanë njohur Kosovën zyrtarisht, nuk duhet të bëhet pengesë që Kosovës t'i ofrohet një udhërrëfyes dhe po ashtu t'i jepet shansi i barabartë për t'i përmbushur reformat e kërkuara. Krejt çfarë kërkohet për t'i shkaktuar dhe nxitur vërtet reformat është që BE-ja t'ia ofrojë Kosovës një udhërrëfyes për viza, njëjtë siç ka ndodhur më parë në rastin e Serbisë dhe të Maqedonisë.

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Zeljko Panteliq:

Në fillim dua të them që i tërë procesi i liberalizimit të vizave mund t'i falënderohet pavarësisht të Kosovës, sepse po të mos kishte ndodhur pavarësia e Kosovës, nuk do të ishte përshpejtuar as procesi i liberalizimit të vizave, e as procesi i lehtësimit të vizave, sepse i tërë procesi i lehtësimit filloi vetëm pas fillimit të bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës dhe në një mënyrë për ta ëmbëlsuar tabletën e hidhur, të cilën Serbia duhej ta kapërdinte, gjegjësisht pavarësimin e Kosovës.

Përgjegjësia e përmbushjes së reformave do t'i mbetet më pas e tëra Qeverisë në Prishtinë.

Ballkani Lindor, Rumania dhe Bullgaria, të cilat shijojnë udhëtim pa viza që nga viti 2001, kanë një popullatë që përben rreth 30 milionë. Të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë një popullsi prej 18 milionësh. A mundet që popullsia e Kosovës prej 2 milionësh të paraqesë një rrezik kaq të lartë të sigurisë për BE-në?

Kosova është vendi që më së shumti ka nevojë për forcën ndryshuese të BE-së dhe të një perspektive evropiane sa më të qartë. Duke mos i ofruar Kosovës udhërrëfyes apo duke e shtyrë vendimin pafundësisht, BE-ja rrezikon ta humb një mundësi të artë për ta përmirësuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe për ta rritur besueshmërinë e saj dhe të EULEX-it në terren. Kosova nuk ka nevojë për trajtim të veçantë, por drejtësia kërkon që Kosovës t'i jepet i njëjti shans për t'i përmbushur reformat e kërkuara dhe si shpërblim të marrë liberalizim e vizave në një të ardhme jo shumë të largët.

(Autorja është eksperte për çështje evropiane në Iniciativën Evropiane për Stabilitet)

KOSOVA "SUI GENERIS" EDHE NË PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Gjeraqina Tuhina



"Sui generis" nuk do jetë sinonim vetëm për statusin përfundimtar të Kosovës. "Sui generis" do të na e përcjellë vendin edhe për një kohë shumë të gjatë, sidomos në proceset që kanë të bëjnë me integrimet evropiane, mu për shkak të rrethanave "Sui generis" të Kosovës.

Kosovën shtet nuk e kanë njohur të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Nga gjithsej pesë vende që refuzojnë njohjen, njëri madje edhe bllokoi secilin hap të Brukselit përballë Prishtinës, i cili do t'i jepte konotacion shtetëror Kosovës. Por kjo nuk vlen për çështjen e vizave, sepse është ky rast që këto shtete, posaçërisht për njërin nga pesëshja, të dëshmojnë se me mosnjohjen e shtetit të Kosovës vetëm mbrohen parimet dhe nuk u bëhet inat qytetarëve të këtij vendi.

Mirëpo edhe procesi i vizave për Kosovën nuk mund t'i ikë formatit "Sui generis". Njëri ndër hapat e parë që shënon nisjen e procesit, nisja e dialogut dhe dorëzimi i udhërrëfyesit, gjithashtu do të jetë "Sui generis". Kjo për arsyen se faktorët relevantë në Bruksel nuk dëshirojnë që kjo letër të ketë emërtimin e njëjtë (udhërrëfyes) sikur në rastet e pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Aktualisht faktorët relevantë në ndërtesën e Komisionit Evropian janë në kërkim të gjetjes së një emërtimi të ri të këtij dokumenti që gjithashtu do jetë "Sui generis". Në substancë, ky dokument do jetë pak a shumë i njëjtë si me pesë udhërrëfyeset që janë dërguar vite më parë në Tiranë, Podgoricë, Shkup, Sarajevë e Beograd. E

secili kryeqytet i lartpërmendur i ka pasur detyrat e shtëpisë gati se të njëjta.

Dhe përderisa zyrtarët e Brukselit po kërkojnë emërtime të reja "Sui generis", ata të Prishtinës munden vetëm të afrohen së paku në dy nga pesë kryeqytetet për të marrë shabllonin dhe të shfrytëzojnë kohën e kërimit të emërtimeve me përmbushjen e kushteve. Kjo do t'i ngjante raportit të profesorit dhe studentit aktiv, i cili në momentin e provimit nuk ka nevojë për angazhim shtesë, sepse ka dëshmuar gjatë periudhës së ligjëratave njohuri dhe zotëron lëndën përkatëse.

Kushtet bazë për procesin e vizave janë të njohura: miratimi i ligjit për riatdhesim dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për riatdhesim me vendet anëtare të Schengenit, strategjia për riintegrim të të kthyerve, avancimi i regjistrimit civil dhe në fund lëshimi i pasaportave biometrike. Të gjitha këto kushte ishin të ditura vite më herët, madje edhe para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, si dhe para vendimit për nisjen e lëshimit të dokumenteve të shtetit të ri të Kosovës, përfshirë këtu edhe pasaportat.

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Sanela Bilalović:

Që dy vjet prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, qytetarët e vendit tonë nuk mund të udhëtojnë në Bosnjë-Hercegovinë. Të gjithë e din se kjo ndodhi prej kur Kosova filloi t'i lëshojë pasaportat e saj. Megjithatë, ky është problem shumë serioz, sepse njerëzit nga Kosova, në mesin e tyre edhe boshnjakët, nuk mund të udhëtojnë në vendlindjen e tyre.

E për plotësimin e kushteve teknike nëpër çfarë janë detyruar të kalojnë edhe pesë shtete të tjera të Ballkanit Perëndimor, nuk ka pengesa nga jashtë. Këtë nuk e parandalon as Spanja, as Rumania, as Qiproja, as Sllovakia e as Greqia. Këtë e parandalon mospuna dhe raportet jo të mira të ekspertëve evropianë që vizitojnë në baza të rregullta Kosovën dhe konstatojnë në Bruksel se nuk janë pjekur kushtet as për të menduar për hapin e parë. Dëshmi e kësaj ishte vizita e fundit e kryeministrit Hashim Thaçi në Bruksel, i cili, pas bisedave të zhvilluara, u detyra të pranonte se "lëvizin" afatet kohore për nisjen e dialogut për viza (hap ky që i paraprin dhënies së udhërrëfyesit). Vetëm pak ditë para ardhjes së Thaçit, njerëzit nga kabineti i tij, të ngarkuar me çështje që kanë të bëjnë me integritet evropian, insistonin se udhërrëfyesi do të vijë në Prishtinë "para pushimeve verore".

Nga këndvështrimi i qytetarit të thjeshtë, në raportet Bruksel-Prishtinë, vizat paraqesin çështjen më të rëndësishme. Kjo, sepse e prek përditshmërinë e secilit, e sidomos në momentin, i cili do të vijë relativisht shpejt, kur tekstualisht të gjithë fqinjët e kosovarëve do të lëvizin lirshëm në drejtim të Evropës Juglindore. Asnjë përparim i vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian nuk do të prekë qytetarët e vendit tonë sa çështja e vizave. A e dinë kosovarët e thjeshtë se të gjitha shtetet në rajon e kanë të nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit me Bashkimin Evropian? A e dinë ata se dy vende të rajonit, Kroacia e Maqedonia, me vite gëzojnë statusin



e kandidatit për anëtarësim të plotë në BE dhe se Kroacia është një hap larg nga anëtarësimi i plotë? A e dinë ata se Shqipëria, Mali i Zi, si dhe Serbia, janë rrugës për të marrë statusin e kandidatit për BE?

Sa për informim: Marrëveshja e Stabilitizimit - Asociimit është raporti i parë kontraktual në mes të një vendi dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, e statusi i kandidatit është një lloj

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Safet Gërxhaliu:

Dhe ajo që është më shqetësuese: kemi pasur raste kur biznesmenëve elitë në Kosovë u është mohuar e drejta për vizë, duke u thënë se nuk keni para të mjaftueshme, ndërsa në dokumentacionin e kërkuar nga ambasada e caktuar Shengen e ka dëshminë se ka në konto bankare më tepër se 1 milion euro dhe kjo është vërtet diçka paradoksale.

garancie se shteti do t'i bashkëngjitet një ditë bllokut më të fuqishëm 27 anëtarësh evropian. Mirëpo për njerëzit e thjeshtë kjo nuk është edhe aq e rëndësishme, e ata më pak të informuar as që i dinë këto shënime, sepse tensioni i gjakut u ngrihet vetëm në momentin kur kujtohen se të gjithë qytetarët përreth munden lirshëm të lëvizin në drejtim të Evropës Perëndimore. Kjo shkakton irritim më të madh për ata, sesa fakti se kosovarët jo që nuk kanë liri të lëvizjes në Evropë, por ata nuk mund të lëvizin as në rajon, e besa as në tërë territorin e shtetit të tyre.

Çështja e vizave është diçka që nuk varet ekskluzivisht nga disponimi politik i Bashkimit Evropian, por ka më shumë karakter teknik dhe përparimi në proces edhe mund të prodhojë rezultate. Duke iu referuar çështjes së vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, komisionari për Zgjerim, Shtefan Fyle,

kishte thënë në një rast se "kryerja e detyrave të shtëpisë sjellë beneficione për qytetarët në vend".

Ajo që politikanët kosovarë do ta quajnë udhërrëfyes e faktorët evropianë me emërtim tjetër, do të bjerë herët a vonë në duart e aktorëve politikë kosovarë. Mirëpo, ai moment nuk do jetë lakmues për politikanët vendorë, sepse do të shënojë gjuajtjen e topit në oborrin e Kosovës. Prej atij momenti nuk mund të tregohet gishti në drejtim të Brukselit, sepse Brukseli në atë rast është mësuesi, i cili pret kryerjen detyrave të shtëpisë nga nxënësit. Në atë rast "Sui generis" mund të jemi vetë ne, nëse nuk i përmbushim obligimet ashtu siç precizohet në dokumentin që vetë po e kërkojmë me këmbëngulje tash e sa kohë.

(Autorja është korrespondente e Radiotelevizionit të Kosovës nga Brukseli)

PROCESI I LIBERALIZIMIT TË VIZAVE, TË ARRITURAT, PËRGJEGJËSITË DHE OBLIGIMET

Besnik Vasolli



Kosova ende mbetet i vetmi vend i cili ende nuk e ka marrë udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, edhe pse pritet që gjatë muajve në vijim të hapet dialogu me Kosovën për liberalizimin e vizave me BE-në.

Sidoqoftë, kjo nuk ishte pengesë që në mënyrë të njëanshme të hartohet dhe aprovohet Udhërrëfyesi dhe Plani i Veprimit për Liberalizim të Vizave, të funksionalizohet mekanizmi ndërinstytucional për koordinimin e këtij procesi dhe të fillojë zbatimin e kriterëve të rëndësishme. Më 15 tetor u publikua dokumenti i ashtuquajtur Studimi për Kosovën, ku u rekomandua që të gjendet një rrugë e përshtatshme që edhe Kosova të hyjë në dialogun për viza dhe më 6 dhjetor 2009, Këshilli i Ministrave i BE-së aprovoi këtë rekomandim dhe kërkoi nga Komisioni Evropian të fillojë përgatitjet e nevojshme. Kjo de-fakto edhe u cilësua nga institucionet kosovare si fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave. Prej atëherë janë mbajtur disa takime me ekspertë të KE-së dhe janë zhvilluar disa misione vlerësuese, të cilat kanë pasur për qëllim të bëjnë vlerësimin e sektorëve relevantë për liberalizimin e vizave.

Ky edhe ishte momenti që u krijua për të

shtyrë zbatimin e kriterëve të përcaktuara, të cilat janë të ndara si më poshtë.

1. Siguria e dokumenteve - kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit

Është arritur progres i konsiderueshëm në funksionalizimin e Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) që ka për qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë dhe cilësisë së lëshimit të dokumenteve. Tani ARC-ja është në fazën e përcaktimit të organogramit të ri dhe të përcaktimit të detyrave për çdo pozitë në nivel qendror dhe lokal. ARC-ja është përgjegjëse për regjistrin civil dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për të krijuar ambient sa më të përshtatshëm për sigurinë e dokumenteve në nivel të vendit dhe në bashkëpunim me zyrtarët e EULEX-it, ka inspektuar 35% zyrave të gjendjes civile dhe qendrave komunale për regjistrim civil.

Janë digjitalizuar më shumë se 75% të librave të regjistrin civil dhe janë hartuar planet konkrete për digjitalizimin e pjesës të mbetur, si dhe skanimin e të gjitha librave të amzës që do ta bëjnë regjistrin civil edhe më të sigurt, për më tepër, janë lidhur në internet më shumë se 95% e zyrave të gjendjes civile.

Si rekomandim i studimit të fizibilitetit për avancimin e sistemit lidhur me lëshimin e dokumenteve biometrike ka lindur nevoja e ndryshimit të kornizës legjislative që ka të bëjë me dokumente personale (pasaportë, letërnjoftim dhe patentë-shofer). Këto akte ligjore tanimë kanë përfunduar dhe janë aprovuar në parim nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa Ligji për Gjendjen Civile është në finalizim e sipër dhe pritet që shumë shpejt të nënshkruhet nga Qeveria dhe të procedohet në Kuvendin e Kosovës.

Për më tepër, sigurisë së dokumenteve në zyrat e gjendjes civile nëpër komuna dhe në QKRC është duke iu kushtuar kujdes i veçantë pasi që kjo është e rëndësishme, siç janë edhe pasaportat biometrike.

2. Bashkëpunimi i agjencive në zbatimin e ligjit, parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, drogave dhe korrupsionit

Me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, që ka të bëjë me luftimin e krimit të organizuar në kuadër të PVPL-së janë paraparë hartimi dhe miratimi i një numri aktesh ligjore. Në këtë drejtim duhet theksuar se Projektligji për Pengimin e Pastrimit të Parave është miratuar nga Qeveria më 22 janar 2010, dhe miratimi nga Kuvendi pritet të ndodhë në korrik 2010. Ky projektligj parasheh themelimin e Njesisë së Inteligjencës Financiare. Projektligjet e tjera në proces të hartimit dhe të aprovimit janë:

- Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është hartuar dhe aprovuar nga Qeveria, pritet të aprovohet edhe nga Kuvendi i Kosovës.
- Projektligji mbi plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, i cili është në fazën finale të hartimit të draftit të parë nga grupi punues
- Projektligji mbi plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës është në fazën finale të hartimit.

Kuvendi i Kosovës më 12 dhjetor 2009 ka miratuar Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit 2009-2011. Brenda vitit 2010 parashihej hartimi, nënshkrimi dhe zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Aleksandra Stiglmayer:

Çështja e statusit nuk është e lidhur me politikën e vizave. Këtë e tregon qartë fakti se BE-ja po negocion për udhëtimin pa viza me Tajvanin, vend ky i cili nuk është njohur nga asnjë vend anëtar i BE-së, apo nga gjërat siç është futja e Kosovës në listën e zezë. Nëse Kosova mund të futet në listën e zezë, atëherë ajo mund të futet edhe në listën e bardhë.

në mes të Agjencisë Antikorrupsion me Prokurorinë e Kosovës.

Është vazhduar me rritjen e numrit të gjyqtarëve që merren me rastet e krimit të organizuar dhe atij financiar, mirëpo duhet theksuar se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të lejuar në të gjitha gjykatat në Kosovë është 392, ndërsa aktualisht janë duke punuar 276 gjyqtarë.

Zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit është duke vazhduar dhe vlen të përmendet suksesi në implementimin e strategjisë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, të arriturat në luftimin e drogës dhe grupeve kriminale, të cilat merren me aktivitete të jashtëligjshme në zbatimin e MIK-ut.

Sa i përket anës institucionale është miratuar struktura e re organizative e Policisë së Kosovës. e cila përfshin edhe krijimin e Njësisë kundër krimit të organizuar, njësi kjo që operon brenda Sektorit të Hetuesisë.

Shërbimi Korrektues ka shtuar numrin e zyrtarëve të shërbimit të tij në kuadër të sektorëve të sigurisë në të gjitha institucionet korrektuese (burgje dhe qendra të paraburgimit) të autorizuar për parandalimin dhe reduktimin e kontrabandës, duke përfshirë edhe drogën.

Gjatë tre muajve të vitit 2010 është arritur më shumë rezultat se gjatë tërë vitit 2009 në arrestimin e personave që janë marrë me trafikimin e lëndëve narkotike dhe janë konfiskuar lëndë narkotike më shumë se gjatë tërë vitit 2009.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar gjyqësor dhe policor

Janë ndërmarrë hapa konkretë në sigurimin e bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor dhe policor, është përcjellë nisma për fillimin e negocimit të Marrëveshjes për "Transferim të personave të dënuar" me vendet anëtare të BE-së, Zvicrën dhe Turqinë.

Policia e Kosovës tashmë ka të nënshkruara disa marrëveshje të bashkëpunimit policor, posaçërisht me shtete fqinje, por edhe me ato ndërkombëtare. Së fundi, ministri i Punëve të Brendshme ka nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim policor me Zvicrën, Francën Gjermaninë dhe është në finalizim të marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim policor edhe me shumë shtete të tjera të BE-së.

Sidoqoftë, anëtarësimi në EUROPOL, INTERPOL, FRONTEX, EGMONT GROUP etj. do të paraqesin një sfidë të vështirë për ta tejkaluar, për vetë faktin që Kosova ende nuk njihet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së apo të Kombeve të Bashkuara.

4. Politikat e azilit

Për menaxhimin sa më të mirë të azilkërkuesve dhe menaxhimit të politikave të azilit janë ndërmarrë veprime konkrete në funksionalizimin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim. Më 17 dhjetor 2009, është inauguruar Qendra e Përkohshme për Azilkërkuesit, si dhe është emëruar stafi menaxhues. Për më tepër, janë bërë përgatitjet për krijimin e databazës për monitorimin e vëllimit të migracionit.

5. Menaxhimi i migrimit

Kosova ende nuk ka politikë dhe regjim të vizave edhe pse MPJ, MPB, PK, EULEX, ICO etj. Kanë themeluar një grup punues për hartimin e procedurave që kanë të bëjnë me lëshimin e vizave. Gjithashtu ka një qëllim që të krijohet një nëngrup punues me përfaqësues të MPB-së dhe MPJ-së, si dhe të ekspertëve të tjerë që do të punojnë në hartimin e kodit specifik uniform të etikës për antikorrupsionin për zyrtarët e MPB-së dhe MPJ-së që merren me lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit, si dhe krijimin e bazës së të dhënave për viza dhe migracion.

Kosova është zotuar të lidhë marrëveshje bilaterale për ripranim dhe në këtë aspekt ka nënshkruar marrëveshjet për ripranim me shtetet e rajonit dhe të BE-së, ndërsa tash për tash është duke i negociuar dhe është afër finalizimit të marrëveshjes me disa prej tyre. Gjithashtu është aprovuar Ligji për ripranim, i cili përcakton procedurat e verifikimit dhe të kthimit të qytetarëve kosovarë dhe të huaj që kanë kaluar nga Kosova në shtetet e tjera.

6. Menaxhimi i kufijve

Sistemi i intranetit dhe lidhja me bazën e të dhënave është bërë në të gjitha pikat kufitare, gjithashtu është themeluar Qendra Monitoruese e MIK-ut në Doganat e Kosovës dhe të Policisë Kufitare, me seli në Doganat e Kosovës dhe bashkërisht në këtë qendër veprojnë zyrtarët doganorë dhe policorë. Nga kjo qendër monitoro-

hen pikat e kalimit të kufirit, përmes kamerave, të cilat janë të instaluar në pikat e kalimit të kufirit dhe janë të lidhura me këtë qendër monitoruese operative.

Është ndërtuar objekti i përbashkët (polici, dogana, AVUK) i pikës kufitare Gilloboçicë - një ndalje, një kontroll, respektivisht kabina të përbashkëta, që paraqet një objekt shumë funksional duke i plotësuar në aspektin e infrastrukturës hapësirën e punës, kërkesat e të gjitha agjencive në kontrollin dhe mbikëqyrje në këtë pikë të kalimit të kufirit. Derisa në Merdar, Kullë dhe Dheu i Bardhë është shtuar edhe nga një korsi për kalimin e automjeteve, si dhe është bërë vlerësimi i infrastrukturës për të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe për objektet e Drejtorisë Rajonale në Veri.

Janë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin dhe ndihmë reciproke në çështje doganore, gjithashtu është nënshkruar marrëveshja ndërkombëtare dypalëshe në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në çështje doganore. Ky është vetëm fillimi dhe duhet kuptuar se ka ende shumë punë për të bërë. Sidoqoftë, ky proces ka rëndësi të shumëfishtë të zbatimit të kriterëve të nevojshme për të arritur liberalizimin e vizave. Ky është proces shtetformues, proces që e bën Kosovën vend të sigurt, stabil dhe të zhvilluar, siç edhe janë shtetet e zhvilluara anëtare të BE-së, e ndihmon procesin e integritimit evropian dhe e ndihmon zhvillimin ekonomik.

Pra, përfitimi është i shumëfishtë dhe duhet kuptuar se secili ka rolin e vet dhe përgjegjësitë personale ashtu siç edhe do t'i gëzojë të mirat e këtij procesi. Është me rëndësi të informohen qytetarët e Kosovës se liberalizimi i vizave nuk e mundëson kërkimin e azilit në shtetet anëtare të BE-së e as nuk e mundëson punësimin në BE. Liberalizimi i vizave thjesht mundëson vetëm udhëtimin në BE dhe qëndrimin atje deri në 90 ditë pa pasur nevojë për vizë.

(Autori është këshilltar i CDF-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme)

APEL I KOSOVËS UDHËHEQËSVE DHE VENDIM- MARRËSVE EVROPIANË

24 qershor 2010

Ne, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët e Kosovës të nënshkruara më poshtë, me durim kemi pritur që Kosovës t'i jepet udhërrëfyesi i vizave. Ka kaluar një vit që nga apeli ynë i fundit. Shumë premtime na janë dhënë, por Kosova mbetet vendi i vetëm në rajon akoma i përjashtuar nga procesi i liberalizimit të vizave.

Përderisa të gjitha vendet e tjera kanë përparuar dukshëm, si Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, që gëzojnë udhëtim pa viza, si dhe Bosnjë-Hercegovina dhe Shqipëria, që pritet shpejt të fillojnë, ne jemi të izoluar po aq sa kemi qenë në verë të vitit 2009. Të gjithë ne, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, ndihemi të bllokuar dhe të harruar.

Ne i kuptojmë shqetësimet e sigurisë së shteteve anëtare evropiane dhe të Komisionit Evropian. Ne i përkrahim kërkesat e tyre për Qeverinë tonë, që të luftojë krimin dhe migrimin jolegal dhe të sigurojë që të gjithë të kthyerit të pranohen me dinjitet. Ne i vlerësojmë përpjekjet e Qeverisë sonë që të përgatisë në mënyrë të njëanshme udhërrëfyenin e vizave. Por, ne nuk kuptojmë pse Kosovës ende nuk i është dhënë udhërrëfyesi i vizave dhe nuk i është thënë çka saktësisht pritet nga Qeveria jonë në aspektin e reformave konkrete.

Shpresat tona u ngjallën kur tetorin e kaluar Komisioni Evropian propozoi të fillojë "viza-dialogun me perspektivë të liberalizimit eventual të vizave", vendim i miratuar nga Këshilli në dhjetor. Ne gjithashtu kemi pasur shpresa të

mëdha që Samiti i Sarajevës në qershor do t'i japë një nxitje të re procesit të integritimit evropian për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do ta çojë drejt përfshirjes së Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave – kërkesë kjo e cila u parashtrua në një apel të përbashkët të nënshkruar nga 471 organizatat të shoqërisë civile nga mbarë rajoni.

Koha është që premtimet të kthehen në vepra. Evropa nuk mund t'i lejojë rreziket e ndërlidhura me izolimin dhe getoizimin e Kosovës. Qeveritë e rajonit kanë demonstruar se ato mund të realizojnë reforma të vështira, nëse kriteret janë qartazi të përcaktuara dhe të matshme si në rastin e liberalizimit të vizave. Ne fuqishëm besojmë se koha është që Qeverisë sonë t'i jepet e njëjta mundësi e barabartë, që t'i realizojë reformat e kërkuara për udhëtim pa viza. Ne u bëjmë thirrje udhëheqësve dhe vendimmarrësve evropianë që t'ia japin Kosovës udhërrëfyenin dhe që formalisht ta përfshijnë menjëherë Kosovën në dialogun e vizave. Kosova si asnjë vend tjetër në rajon ka nevojë për fuqinë transformuese të procesit integruar evropian dhe ne, si të gjithë të tjerët, dëshirojmë të jemi pjesë e Evropës.

Nënshkruar nga:


1. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
2. Instituti "Riinvest"
3. Klubi për Politikë të Jashtme
4. Iniciativa Evropiane për Stabilitet
5. KIPRED

6. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
7. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
8. Qendra për Politika dhe Avokim
9. Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor, Prishtinë
10. Lëvizja Evropiane në Kosovë
11. Lëvizja FOL
12. Urban FM
13. Fondacioni "Friedrich Ebert"
14. Grupi për Hulumtime në Sociologji dhe Filozofi
15. Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë
16. Instituti Ballkanik i Politikave, IPOL
17. Qendra Kosovare për Edukim
18. Instituti "Riinvest"
19. Instituti për Kulturë dhe Sport
20. Qendra për Politika Evropiane dhe Politikë
21. Iniciativa për Progres, INPO
22. Çelnaja
23. Community Building Mitrovica
24. JEF Kosova
25. Instituti Demokratik i Kosovës
26. Qendra për Integritim e Komuniteteve, Prizren
27. Uni Group Junior Enterprise
28. Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Prishtinës
29. Instituti i Prishtinës për Studime Politike, PIPS
30. Instituti GAP
31. Qendra e Kosovës për Politika Publike
32. OJQ "Durmish Aslano", Prizren
33. Media Centar, Çaglavica
34. OJQ "Kosovski Avaz"



SEKTORI I SIGURISË NË KONTEKST TË PROCESIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Florian Qehaja



Sektori i sigurisë paraqet segmentin kyç të zhvillimit institucional në Kosovën e pavarur. Në fakt, fjala është për një sektor relativisht të ri i paraparë me Kushtetutë të Republikës së Kosovës pas një administrimi të UNMIK-ut, e cila kishte kompetenca të rezervuara mbi këtë sektor dhe frenoi tentativat për forcimin e pronësisë vendore në këtë aspekt. Kur flasim për sektorin e sigurisë në ditët e sotme, atëherë, në krahasim me shtetet e rajonit, Kosova nuk bën pjesë në procesin e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) mirëpo më shumë konsiston në Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë (ZHSS). Me përjashtim të Policisë së Kosovës, e cila është themeluar tash e 11 vjet dhe që kërkohet një reformim substancial, institucionet e tjera të sigurisë janë në themelim e sipër. Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës janë në fazën fillestare të ngritjes.

Duke mos hyrë në detaje të funksionimit të këtij sektori, shtrohet nevoja e elaborimit të progresit të deritashëm të institucioneve të sigurisë në raport me procesin e liberalizimit të vizave. Është

më se e qartë që aspekti politik dhe pengesat strategjike po e frenojnë Kosovën në një progres në bashkëngjitje në Shengenin e bardhë, mirëpo kjo nuk do të thotë se institucionet qeveritare dhe aktorë të tjerë të ndalen në plotësimin e kriterëve teknike duke u bazuar në praktikën e shteteve të tjera. Aspektet që ndërlidhen me sektorin e sigurisë dukshëm reflektojnë ngecje dhe një mosefikasitet në arritjen e standardeve që kërkohen.

Pikësëpari, ngritja e mekanizmave të mbrojtjes së të dhënave personale është shumë e rëndësishme, ndërsa Qeveria e Kosovës qartazi ka qenë shumë joefektive në ngritjen e tyre. Pas përpjekjeve të shumta, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është aprovuar në Kuvend rishtazi, mirëpo implementimi i saj ende nuk ka filluar. Edhe pse Ligji është në përputhje të plotë me Direktivën e BE 95/46/EC, ende nuk janë bërë hapat fillestarë për themelimin e Agjencisë Nacionale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për më shumë, vlen të theksohet se kapacitetet në këtë sferë janë inekzistente. Ligji është shkruar nga një ekspert ndërkombëtar, mirëpo për implementimin e tij nevojitet ngritja e kapaciteteve vendore. Mbrojtja e të dhënave personale përbën një aspekt kyç për liberalizimin e vizave, ngase të dhënat personale konsiderohen si element themelor i të drejtave të njeriut në BE. Edhe pse vetëm tërthorazi ka të bëjë me këtë proces, mungesa e Ligjit për klasifikimin e informacioneve përbën një fakt shqetësues. Aq më parë që kapacitetet në këtë drejtim duhet ngritur nga zeroja.

Reformimi i Policisë së Kosovës është duke u bërë me hapa të ngadalshëm. Policia konsiderohet si një institucion vital në Kosovë dhe relativisht funksional, mirëpo, sipas vlerësimeve, mundësitë për përballje me sfida të mëdha që tejkalojnë detyrat elementare të rendit dhe sigurisë publike janë të kufizuara. Luftimi i krimit të organizuar dhe në veçanti trafikimit të qenieve njerëzore është një nga parakushtet që PK ka treguar rezultate modeste. Krahas mangësive kadrovike dhe buxhetit të kufizuar, Ministria e Punëve të Brendshme dhe PK nuk kanë arritur që të formalizojnë marrëveshje bashkëpunimi me shtetet në rajon, përveç me disa. PK në raste kyçe nuk merr pjesë në operacionet rajonale për luftimin e grupeve kriminale dhe shumë pak janë bërë përpjekje për integrimin në qendrat rajonale të bashkëpunimit. Në këtë drejtim duhet kritikuar joefikasitetin e EULEX-it që të ndihmojë procesin e bashkëpunimit rajonal të PK duke i pasur parasysh pengesat politike. Mospjesëmarrja në iniciativat rajonale për luftimin e krimit të organizuar pengon shumë procesin e liberalizimit.

Për më shumë, Integrimi i Menaxhuar i Kufirit reflekton pjesën kryesore të kriterëve dhe në këtë drejtim kërkohet zhvillim i shpejtë. Në fakt, implementimi i Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ka arritur deri në një nivel, por larg nga standardet e kërkuara. Policia kufitare ka kapacitete të kufizuara për menaxhimin e kufirit. Nevoja për ngritjen e kapaciteteve humane dhe teknike të Policisë Kufitare është tepër e madhe duke e pasur

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Augustin Palokaj:

Nëse Kosova vazhdon të jetë vendi me popullatë më të izoluar në Evropë, kjo do të ndikojë shumë edhe në politikën afatgjate të Bashkimit Evropian, në stabilizimin e rajonit të Ballkanit, sepse mungesa e lirisë së lëvizjes do të japë punë edhe për krimin e organizuar, pra për rrjetet që bëjnë kontrabandë me njerëz.



parasysh që duhet gradualisht të merren kompetencat nga njësitet e KFOR-it që janë në redukim e sipër. Deri tani vija e gjelbër e kufirit është marrë përsipër vetëm në kufi me Shqipërinë dhe ende s'është bërë një gjë e tillë në kufirin me Maqedoninë dhe Malin e Zi. Kufiri me Serbinë është një ndër më të rëndësishmit, ngase fjala është për një vijë kufitare mbi 380 km që në fakt është më shumë se gjysma e vijës së gjelbër kufitare të Kosovës me fqinjët (në tërësi vija e gjelbër është mbi 740 km).

Një ndër aspektet më sfiduese për Qeverinë është procesi i riatdhesimit. Numri i madh i emigrantëve ilegalë kosovarë në Evropë kërkon nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare për riatdhesim. Kostoja financiare e këtij procesi është pothuajse e papërbalueshme në mungesë të një vizioni për qasjen e këtij aspekti. Edhe pse janë evidencuar marrëveshje të MPB së Kosovës me ministrinë respektive të shteteve anëtare, implementimi i tyre do të ketë konsekuencë në vitet që do të pasojnë.

Vërehet një përkushtim për implemen-

timin e parakushtit për imigrantët e huaj në Kosovë. Mbështetja e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian ka bërë që të ndërtohet një qendër për imigrantët nga vendet e treta edhe pse infrastruktura ligjore dhe politikat në këtë drejtim mungojnë. Mirëpo, pavarësisht ekzistimit të ligjit për të huajt, ai nuk implementohet. Qytetarët nga Serbia dhe Mali i Zi hyjnë në territorin e Kosovës me çfarëdo dokumenti identifikimi pavarësisht që kjo është në shpërputhje me ligjin që kërkon hyrjen e qytetarëve të huaj me pasaportë, përveç nëse nuk është vendosur ndryshe me marrëveshje bilaterale ose ndërkombëtare. Politizmi i mëtejmi i kësaj çështjeje frenon procesin e liberalizimit të vizave. Po ashtu Kosova nuk ka ende politika për vendosjen e vizave për vendet e treta e që është kusht po ashtu i rëndësishëm. Themelimi i ambasadeve dhe shërbimeve konsullore duhet të shkojë paralelisht me zhvillimin e politikave për regjim të vizave. Në fund, lufta kundër korrupsionit është një ndër dobësitë më të mëdha. Gjyqësori i dobët dhe përhapja e këtij fenomeni në të gjitha segmentet e qeverisjes përbën një nga aspektet me rezultatet më të dobëta në praktikë. Korrupsioni do të paraqitet si një problem që është vështirë të sfidohet duke e pasur parasysh një popullatë të vogël, e lidhur në baza familjare e shoqërore dhe nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik. Për më shumë, vonesat e

theksuara në konsolidimin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës ngadalësojnë parandalimin e kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj vendit dhe qytetarëve, e në veçanti krimin e organizuar.

Ka edhe shumë aspekte të tjera që kërkojnë domosdo konsolidimin e institucioneve të sigurisë e që kanë të bëjnë me procesin e liberalizimit. Politikat sektorale në institucionet e sigurisë nuk janë të mjaftueshme dhe se mungon strategjia e sigurisë nacionale. Pavarësisht vonesave në hartimin e strategjisë nacionale të sigurisë, është shumë e rëndësishme që ajo të kalojë në një proces demokratik dhe të reflektojë nevojat vendore dhe vizionin tonë për integrim në BE. Plotësimi i parakushteve për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës do të bëhet vetëm atëherë kur sektori i sigurisë është i aftë të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të shkarkohet nga 'varësia' e mëtutjeshme që ka ndaj pranisë civile e ndërkombëtare.

(Autori është hulumtues i lartë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë)

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Tanja Fajon:

Mendoj se nuk duhet të rrezikojmë duke e lënë Kosovën anash, sepse kanë kaluar 20 vjet qëkur e festuam rënien e Murit të Berlinit, ndërsa sot kemi mure të vizave në Ballkanin Perëndimor.

Citat nga dokumentari i Forumit 2015 'Te jetosh ne geto'

Agron Rezniqi:

Një refuzim që më është bërë mua dhe të cilin unë e konsideroj një gjë jo të kulturuar prej Ambasadës Gjermane ka qenë kur ata kanë kërkuar, pasi që i kam kompletuar të gjitha dokumentet, që unë t'ua sillja gjendjen bankare të partnerit në Gjermani.

UDHËRRËFYESI I SHQIPËRISË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE ME BE-në 2 qershor 2008



I. HYRJE – KORNIZA E PËRGJITHSHME

A. Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme, në konkluzionin e tij të 28 janarit 2008, mirëpriti qëllimin e Komisionit Evropian për ta nisur dialogun për viza me të gjitha vendet e Ballkanit dhe shprehu gatishmërinë e tij për ta diskutuar më tej këtë çështje, bazuar në komunikatat e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, me qëllim të përcaktimit të udhërrëfyesve të detajuar, të cilët i përcaktojnë qartazi standardet që duhet të arrihen nga të gjitha vendet e rajonit, në mënyrë që gradualisht të shkohet drejt liberalizimit të vizave. I tërë procesi do të monitorohet për së afërmi nga Këshilli dhe Komisioni i Bashkimit Evropian, i cili do ta vlerësojë progresin për secilin vend përkatës dhe do ta ndjekë me vëmendje miratimin dhe implementimin e reformave të nevojshme drejt heqjes së kërkesave për viza.

Komisioni Evropian do të raportojë rregullisht në Këshillin Evropian për zbatimin e këtij udhërrëfyesi. Hera e parë do të jetë para përfundimit të vitit 2008, veçanërisht duke marrë të dhëna nga ekspertët e saj, si dhe duke përfshirë ekspertët nga shtetet anëtare në kuadër të dialogut të vizave.

B. Për përcaktimin e metodologjisë për procesin e liberalizimit të vizave, elementet e mëposhtme do të merren në konsideratë:

Perspektiva evropiane për shtetet e Ballkanit Perëndimor;
Përkushtimi politik i marrë nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave afatshkurtra për qytetarët e shteteve të Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës së Selanikut, e cila në nivel politik është konfirmuar disa herë nga një seri konkluzionesh nga Këshilli Evropian që nga viti 2003¹;
Konkluzioni nga të gjitha shtetet e rajonit për marrëveshje të riatdhesisimit nga Bashkimi Evropian;
Lirimi nga vizat për qytetarët e BE-së nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor;

Si hap të parë konkret i ndërmarrë drejt përmirësimit të kontakteve ndërnjerëzore, komuniteti evropian ka përfunduar në vitin 2007 marrëveshjen për lehtësimin e vizave me Shqipërinë, Bosnjë- Hercegovinën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe me Serbinë. Këto marrëveshje janë në fuqi që nga 1 janari 2008. Preambula e marrëveshjeve për facilitimin e vizave përmban një referencë të qartë për angazhimin e palëve që të punojnë së bashku për të arritur një regjim pa viza për udhëtim në të ardhmen.

C. Duke pasur parasysh një gamë të gjerë çështjesh relevante për dialogun për liberalizimin e vizave dhe nevojën për krijimin e rrethanave të sigurisë për udhëtim të lirë pa viza, objektiva e këtij ushtrimi është që t'i identifikojë të gjitha masat e nevojshme për t'u

miratuar dhe zbatuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendosja e kërkesave të qarta që kërkojnë të arrihen në një të ardhme të afërt. I tërë procesi do të ndahet në katër grupe çështjesh, të cilat do të mbulohen nga procesi i dialogut: siguria e dokumenteve, migrimi ilegal, siguria dhe rendi publik, si dhe aspekte të jashtme që lidhen me lëvizjen e personave. Dialogu do të jetë tailor-made², për t'i lejuar secilit vend që t'i fokusojë përpjekjet në reformat që nevojiten dhe në adresimin e kërkesave të BE-së. Shpejtësia e lëvizjes drejt liberalizimit të vizave do të varet nga progresi që do të bëjë secili vend, varësisht nga përmbushja e kushteve të parapara.

Sa i përket strukturës, i tërë dialogu si pjesë e politikës së përgjithshme të BE-së drejt vendeve me status të kandidatit, dhe atyre kandidatë potencialë të Ballkanit Perëndimor, do të zhvillohet brenda kuadrit të strukturave të procesit të Stabilizim-Asociimit. Procesi i liberalizimit të vizave do të drejtohet nga zyrtarë të lartë, të cilët do të kenë kompetenca që të vendosin për organizimin e takimeve teknike në nivel ekspertësh për çështje të veçanta. Çështja e raportimit për progresin e arritur në çështjet që kanë të bëjnë me procesin e liberalizimit të vizave do të sigurohet brenda kornizave të Njësisë së Posaçme për Konsultim dhe strukturave të cilat do të krijohen në

¹ Më së voni në konkluzionin e Këshillit 18/6/07 dhe 10/12/07

² Tailor-made është shprehje e përdorur shpesh nga BE-ja, që do të thotë i dizajnuar në bazë të specifikave për secilin vend

kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë.

D. I tërë procesi do t'i lejojë Komisionit Evropian që të bëjë një propozim në momentin e duhur në Këshillin Evropian për heqjen e obligimeve për viza për qytetarët shqiptarë, përmes amendamentimit të rregullores së Këshillit 539/2001. Mbi bazat e propozimit të Komisionit, Këshilli, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, do të vendosë me shumicë të kualifikuar.

UDHËRRËFYES DREJT NJË REGJIMI PA VIZA PËR SHQIPËRINË

Kërkesat lidhur me zbatimin korrekt të marrëveshjeve me komunitetin (Bashkimin Evropian) për lehtësimin e vizave dhe riatdhesimin

A. Marrëveshja e ripranimit:

Shqipëria duhet t'i ndërmarrë masat e duhura për të siguruar zbatimin efektiv të marrëveshjes për riatdhesim me komunitetin dhe në veçanti zëvendësimin e marrëveshjeve të mëhershme bilaterale apo rregullimin e tyre mbi bazën e marrëveshjes për riatdhesim me komunitetin, konkluzionet për "zbatimin e protokolleve" me vendet anëtare, miratimin e masave që sigurojnë se infrastruktura e nevojshme është në vendin e duhur, në veçanti staf të mjaftueshëm që merret me aplikimet e ripranimit, respektimin e afateve të ndryshme të vendosura nga marrëveshja për riatdhesim me komunitetin, pranimin e "dokumenteve standarde të udhëtimit të BE-së për qëllime të dëbimit", pranimin e aplikacioneve të ripranimit për qytetarët e vendit të tretë/personave pa shtetësi.

B. Marrëveshje për lehtësimin e vizave

Shqipëria do të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin Evropian për ta përkrahur zbatimin e marrëveshjes për lehtësimin e vizave me vendet anëtare të BE-së, duke siguruar në veçanti monitorimin e vazhdueshëm të të gjitha institucioneve, autoriteteve dhe të tjerë të përfshirë në zbatimin e kësaj

marrëveshjeje në Shqipëri, në lidhje me lëshimin e ftesave, certifikatave dhe dokumenteve.

Kërkesat për sigurinë e dokumenteve, migrimin ilegal, sigurinë dhe rendin publik, si dhe marrëdhëniet me jashtë

BLLOKU 1: Siguria e dokumenteve Pasaportat/dokumentet e udhëtimit, kartat e identitetit dhe dokumentet shumëzuese (breeder documents)

Shqipëria duhet:

- Të lëshojë dokumente biometrike të udhëtimit, të lexueshme nga makineritë në pajtim me standardet ICAO dhe EC, dhe gradualisht t'i fusë të dhënat biometrike, duke përfshirë fotot dhe shenjat e gishtërinjve;
- Të miratojë dhe të zbatojë masa të nevojshme, që sigurojnë integritetin dhe sigurinë e procesit të individualizimit dhe të shpërndarjes;
- Të krijojë programe të trajnimit dhe adaptimin e kodit të etikës kundër korrupsionit, duke vënë në shënjestër zyrtarët e cilitdo autoritet publik që merret me viza dhe pasaporta;
- Të raportojë në data-bazën e Interpol/LASP për pasaportat e humbura dhe të vjedhura;
- Të sigurojë nivel të lartë të sigurisë së dokumenteve shumëzuese, duke përfshirë edhe regjistrin civil, si dhe kartat e identitetit dhe të përcaktojë procedura të prera rreth lëshimit të tyre.

BLLOKU 2: Migrimi ilegal, duke përfshirë ripranimin

Menaxhimi i kufijve

Shqipëria duhet:

- Të miratojë dhe të zbatojë legjislacionin që rregullon lëvizjen e personave në kufijtë e jashtëm, si dhe

ligjin mbi rregullimin e autoriteteve kufitare dhe funksioneve të tyre në pajtim me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (SKMIK) dhe planin e saj të veprimit, të hartuar në shtator të vitit 2007;

- Të marrë masa të nevojshme buxhetore dhe administrative për të siguruar infrastrukturë efikase, pajisje dhe IT teknologji në kufijtë e jashtëm;
- Të krijojë programe trajnimit dhe të miratojë kodin e etikës kundër korrupsionit, që vë në shënjestër rojet e kufirit, doganat dhe zyrtarët e tjerë të përfshirë në menaxhimin e kufirit;
- Të përfundojë marrëveshje me FRONTEx-in.

Përgjegjësitë transportuese

Shqipëria duhet të miratojë dhe të zbatojë legjislacionin për përgjegjësitë transportuese dhe përcaktimin e sanksioneve;

Politikat e azilit

Shqipëria duhet:

- Të miratojë dhe të zbatojë legjislacionin në fushën e azilit, në harmoni me standardet ndërkombëtare (Konventën e Gjenevës së vitit 1951 me Protokollet e Nju-Jorkut), si dhe standardet dhe kornizën ligjore të BE-së;
- Të sigurojë infrastrukturën e nevojshme dhe të forcojë mekanizmat përgjegjës, në veçanti në fushën e procedurave të azilit dhe në pranimin e azilkërkuesve.

Menaxhimi i migracionit

Shqipëria duhet:

- Të hartojë dhe të fillojë zbatimin e një mekanizmi për monitorimin e flukseve të migracionit, duke caktuar një profil rregullisht të freskuar me të dhëna për Shqipërinë, me të dhëna edhe për migracionin legal dhe ilegal,

si dhe të krijojë organe përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi fluksin e migracionit;

- Të zbatojë Strategjinë Kombëtare për Migrimin dhe Planin e saj të Veprimit, e miratuar në maj 2005, duke përfshirë përkrahje të qëndrueshme financiare dhe sociale;
- Të përcaktojë dhe të zbatojë metodologjinë për zbulim të brendshëm dhe të marrë masa që i përmirësojnë kapacitetet hulumtuese në rastet e organizuara dhe të ndihmuara të migracionit të paligjshëm;
- Të hartojë dhe të zbatojë ligjin mbi pranimin dhe qëndrimin e qytetarëve të vendit të tretë, duke përcaktuar të drejtat dhe obligimet për personat në fjalë (duke përfshirë anëtarët e familjes të personave të tretë);
- Të sigurojë dëbimin efektiv të personave të vendit të tretë me qëndrim të paligjshëm nga territori i saj.

BLLOKU 3: Siguria dhe rendi publik

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit

Shqipëria duhet:

- Të hartojë dhe të zbatojë draft-strategjinë për luftimin e krimit të organizuar (në veçanti aspektet ndërkufitare), përmes hartimit dhe zbatimit të një plani të veprimit, duke përfshirë një kornizë kohore, masat për forcimin e kapaciteteve institucionale, të sigurojë koordinimin ndërmjet agjencive dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore e financiare;
- Të hartojë dhe të zbatojë draft-strategjinë për ta luftuar trafikimin me qeniet njerëzore, si dhe një plan të veprimit me përcaktues të qartë kohorë dhe me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;

- Të hartojë dhe të zbatojë një strategji kombëtare për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, të hartojë dhe të zbatojë ligjin për parandalimin dhe financimin e terrorizmit; të zbatojë legjislacionin relevant për konfiskimin e aseteve të kriminelëve (duke përfshirë dispozitat që adresojnë aspektet ndërkufitare);

- Të zbatojë strategjinë kombëtare 2004-2010 kundër trafikimit të drogës dhe Planin e Veprimit Kombëtar kundër Drogës, të japë informacione për kapjen e drogës dhe personave të përfshirë të kapur në pikat e kalimit të kufirit, t'i zhvillojë më tej bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me organet relevante ndërkombëtare në fushën e drogës;

- Të zbatojë Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit 2007-2013 për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, të hartojë dhe të zbatojë një plan të veprimit kundër korrupsionit, të përfshijë një kornizë kohore, si dhe masat për forcimin e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimin ndërmjet agjencive, si dhe të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;

- T'i zbatojë konventat relevante të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës, si dhe rekomandimet e GRECO-s dhe standardet e tjera ndërkombëtare në fushat e listuara më lart, si dhe në luftën kundër korrupsionit.

Bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale

Shqipëria duhet:

- T'i zbatojë konventat ndërkombëtare për sa i përket bashkëpunimit gjyqësor për çështje penale (në veçanti Konventën e Këshillit të Evropës);
- Të marrë masa që synojnë përmirësimin e efikasitetit në fushën e bashkëpunimit gjyqësor me shtetet

anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera në rajon, në çështje penale të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Të zhvillojë marrëdhënie pune me Eurojustin, kryesisht përmes pikës së kontaktit të Eurojustit.

Bashkëpunimi në fushën e sundimit të ligjit

Shqipëria duhet:

- Të marrë hapa të nevojshëm për të siguruar efikasitetin e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive kombëtare relevante, në veçanti rojat e kufirit, policisë, oficerëve doganorë, si dhe bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore;
- Të përmirësojë shkëmbimin e informatave ndërmjet agjencive kombëtare, duke vendosur mekanizëm adekuat të koordinimit;
- Të përforcojë ligjin për bashkëpunim rajonal dhe të zbatojë marrëveshje funksionale të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, duke përfshirë ndarjen me kohë të informacionit relevant me autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit të vendeve anëtare të BE-së;

- T'i përmirësojë kapacitetet operative dhe ato të hulumtimit special të organeve për zbatimin e ligjit për të ndaluar më me efikasitet krimin ndërkufitar;

- Të ndërmarrë hapa të nevojshëm që të përgatitet për përfundimin e një marrëveshjeje për bashkëpunim operacional me Europolin, me theks të veçantë në mbrojtjen e provizioneve për mbrojtjen e të dhënave.

Mbrojtja e të dhënave

Shqipëria duhet:

- Të zbatojë Ligjin për mbrojtjen e të dhënave, i miratuar në mars 2008 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe

t'i zbatojë provizionet e saj duke përfshirë krijimin e një autoriteti mbikëqyrës të pavarur për mbrojtjen e të dhënave me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;

- T'i nënshkruajë, t'i ratifikojë dhe t'i zbatojë konventat ndërkombëtare relevante, siç janë protokollin shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.

Blloku 4: Marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore

Liria e lëvizjes së qytetarëve shqiptarë

Shqipëria duhet:

- Të sigurojë që liria e lëvizjes së qytetarëve shqiptarë nuk është subjekt i kufizimeve të paarsyeshme, siç janë masat e ndonjë natyre diskriminuese, bazuar në çfarëdo baze, sikurse në: gjini, racë, ngjyrë, prejardhje etnike apo sociale, tipare gjenetike, gjuhë, fe dhe besim, mendime politike apo çfarëdo mendimi tjetër, anëtar i pakicës kombëtare, lindje, paafësi, si dhe moshë e orientim seksual.

Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit

Shqipëria duhet:

- Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit për të gjithë qytetarët, duke përfshirë gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat që u përkasin minoriteteve dhe grupet e tjera vulnerable (të cenueshme);
- Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet e identitetit për refugjatët.

Të drejtat e qytetarëve, duke përfshirë të drejtat e minoriteteve



Shqipëria duhet:

- Të miratojë dhe të zbatojë legjislationin, për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit;
- T'i saktësojë kushtet dhe rrethanat për përvetësimin e shtetësisë shqiptare;
- Të sigurojë hetimin e incidenteve të motivuara etnikisht nga zyrtarët për zbatimin e ligjit në fushën e lirisë së lëvizjes, duke përfshirë rastet që kanë për shënjestër anëtarët e minoriteteve;
- Të sigurojë monitorimin e provizioneve kushtetuese për mbrojtjen e minoriteteve;
- Të zbatojë politika përkatëse për të gjitha minoritetet, duke përfshirë romët.

Vërejtjet përfundimtare:

Ky udhërrëfyes përfshin një listë masash që kërkohen për t'u ndërmarrë nga Shqipëria në funksion të heqjes së obligimeve për viza. Këto masa kanë për qëllim përgjigjen e nevojave të identifikuar, bazuar në informatat aktualisht në dispozicion. Në rast të ndonjë ndryshimi substancial të situatës momentale, Komisioni mund të propozojë rishikimin dhe ripërshtatjen e udhërrëfyesit.

Bazuar në arritjet nga Shqipëria në zbatimin e kërkesave të dhëna nga ky udhërrëfyes, Komisioni Evropian do ta vlerësojë situatën, duke marrë parasysh edhe kriteret e tjera, shkallën e refuzimit të vizave për konkurruesit shqiptarë dhe shkallën e refuzimit të hyrjes në fushën e përbashkët të Shengenit për qytetarët shqiptarë. Në këtë kontekst, trendi në rënie i shkallës së refuzimit, i cili duhet të shkojë drejt 3% për viza dhe 1.000 për vit, që u refuzohet hyrja në zonën e përbashkët të Shengenit, do të përdoret si indikator tregues. Gjithashtu, Shqipëria duhet t'i marrë masat e duhura për ta lejuar zbatimin efikas të veprimeve të përbashkëta të BE-së për ndalimin e udhëtimit. Siç është përmendur më herët, mbi këto baza, Komisioni do ta konsiderojë mundësinë për ta prezantuar një propozim në Këshill për heqjen e obligimit për viza, duke amendamentuar Rregulloren e Këshillit 539/2001, si dhe duke ndjekur procedurat e përcaktuara në Traktatin e KE-së³ për këto çështje. Këshilli, pastaj, mbi bazën e propozimit të Komisionit, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, do të marrë vendim me shumicë të kualifikuar. Nga një amendament i tillë do të mund të shpejti të përfitonin mbajtësit e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara në pajtim me standardet e ICAO-së dhe EC-së.

³ Artikulli 67.3 dhe Artikulli 62.2.b.i

PËRTEJ PRIT-DHE-SHIH: RRUGA PËRPARA E POLITIKËS SË BE-SË NDAJ BALLKANIT

(Heather Grabbe, Gerald Knaus dhe Daniel Korski)



EUROPEAN
COUNCIL
ON FOREIGN
RELATIONS
ecfr.eu

PËRMBLEDHJE

Në mesin e një krize të madhe ekonomike, liderët e Bashkimit Evropian mund lehtësisht të joshen që të pezullojnë çdo vendim të ardhshëm mbi procesin e zgjerimit. Megjithatë, tani kur disa vende të Ballkanit Perëndimor kanë testuar angazhimin e BE-së, duke aplikuar edhe formalisht për anëtarësim, qasja prit-dhe-shih është e paqëndrueshme. BE-ja ka mbajtur gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor— Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë, duke pritur për një dekadë. BE-ja ka kërkuar nga to ndërmarrjen e reformave të vështira dhe ambicioze që të përgatiten për anëtarësim.

Sidoqoftë, liderët e Ballkanit tashmë nuk janë të sigurt që shtetet e BE-së i dëshirojnë vërtet brenda klubit. Si rezultat, besueshmëria e BE-së në rajon është duke u zbehur. Nëse BE-ja vazhdon të ngurrojë në të njëjtën mënyrë edhe për hapat në vazhdim, atëherë edhe fuqia e tij do të zbehet gjithashtu.

BE-ja duhet t'u përgjigjet pozitivisht aplikacioneve për anëtarësim nga vendet e Ballkanit, por njëkohësisht duke përforcuar kushtet e saj të pranimit. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është angazhimi i mjeteve ekzistuese të BE-së në mënyrë më të plotë dhe më efektive për të zënë më mirë hapat e ardhshëm në rrugën e integritit. Kjo do të përkrahte reformat në rajon pa imponuar ndonjë kosto shtesë mbi BE-në. Qëllimi është që të vendoset një program i qartë, realist dhe motivues që të ndihmojë vendet e Ballkanit që të përgatiten për anëtarësim – gjë që do të merrte shumë vjet për t'u arritur. Kjo do të forcojë qeverisjen dhe do të krijojë moment politik që do të ndihmojë rajonin të kalojë krizën momentale ekonomike dhe politike.

Hyrje

Në Samitin e Selanikut në qershor 2003, Këshilli Evropian dhe të gjitha shtetet e anëtare të BE-së deklaruan "përkrahjen e tyre të plotë për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor" dhe deklaruan se "E ardhmja e Ballkanit është brenda Bashkimit Evropian." Deklarata e Selanikut u dha perspektivë konkrete për anëtarësim Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Jugosllavisë¹. BE-ja gjithashtu ka investuar miliarda euro ndihmë financiare për të ndihmuar ndërtimin e shteteve dhe rindërtimin e infrastrukturës dhe ka vendosur disa misione ushtarake dhe civile për të ndihmuar në mbajtjen e paqes.

Kjo ka inkurajuar vendet e Ballkanit që të ndërmarrin hapa të mëdhenj përpara. Diplomacia e BE-së ishte vendimtare për të bindur Maqedoninë që të zbatonte Marrëveshjen e Ohrit që ndaloi kryengritjen e armatosur të vitit 2001. BE-ja luajti një rol të rëndësishëm në shpërbërjen e qetë të unionit shtetëror mes Serbisë dhe Malit të Zi. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Asociimit me BE-në i ndihmoi demokratët pro-BE-së në zgjedhjet e Serbisë në vitin 2008 që të fitonin kundrejt nacionalistëve radikalë, të cilët ishin irrituar nga Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Qytetarët e tri shteteve ballkanike (Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë) arritën udhëtimin e lirë pa-viza për në BE në vitin 2009, përderisa dy të tjerat (Shqipëria dhe Bosnja) pritet të pasojnë

së shpejti. Komisioni Evropian ka deklaruar që Maqedonia është e gatshme të fillojë negociatat për anëtarësim - megjithatë Greqia bllokoi përmes përdorimit të drejtës së vetos caktimin e një date për fillimin e negociatave, duke qenë se Greqia refuzon të pranojë emrin e Maqedonisë. Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia kanë parashtruar gjithashtu kërkesat për anëtarësim.

Megjithatë, edhe pse BE-ja në mënyrë unanime është pajtuar në parim për të ardhmen evropiane të vendeve të Ballkanit, ajo ka ndjekur një politikë prit-dhe-shih për sa i përket kohës se kur ato mund të fillojnë negociatat për anëtarësim. Kësaj qasjeje është duke i mbaruar afati. Për 10 vjet, qysh pas përfundimit të konfliktit të Kosovës (1999) dhe konfliktit të Maqedonisë (2001), shpresa për anëtarësim në BE ka nxitur reformat dhe pajtimin mes vendeve në rajon, përderisa BE-ja dhe NATO-ja kanë punuar së bashku për të mbajtur paqen. Njëjtë sikurse anëtarët themeltarë të BE-së para një gjysmë shekulli më parë, edhe vizioni i përbashkët për të ardhmen që këto vende sapo të pavarura, të ndjeshme dhe ende të dyshimta kanë të përbashkët. Por tashmë ka ardhur koha që BE-ja të vendosë nëse do të fillojë mbajtjen e premtimit që kishte bërë. Shtetet tashmë edhe formalisht janë duke aplikuar për anëtarësim, kurse liderët e BE-së janë duke ngurrar në pranimin e tyre.

¹ Në atë kohë Jugosllavia konsistonte në Serbinë (duke përfshirë Kosovën) dhe Malin e Zi

Dy rreziqe

Politika prit-dhe-shih është rezultat i kufizimit të BE-së mes dy rreziqeve konkurruese. Njëri rrezik është se anëtarësimi i shteteve të dobëta me çështje të pazgjidhura mund të dëmtojë vetë BE-në. Shumë politikëbërës në Bruksel dhe në kryeqytete evropiane e shohin si alarmante perspektivën e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Me përjashtim të Kroacisë – e cila ka gjasa për t'u anëtarësuar në vitin 2013 – vendet e Ballkanit Perëndimor janë ndër vendet më të varfra në historinë e zgjerimit të BE-së që aplikojnë për anëtarësim në BE. Të gjitha kanë ekonomi jokonkurruese të ngarkuara me numër të lartë të papunësisë. Edhe pse ato kanë shënuar progres në qeverisje, disa nga to mbesin prapë shtete të dobëta. Shumica nga to para do kohe kishin provuar konflikte të hidhura dhe përçarje politike. Disa nga to ende kanë çështje të hapura me fqinjët, për shembull Maqedonia me Greqinë, apo kanë çështje të pazgjidhura kushtetuese e statusore, sikurse Bosnjë- Hercegovina, Kosova dhe Serbia. Në kohën kur BE-ja është duke luftuar për themelimin e institucioneve të reja me traktatin e Lisbonës, disa nga vendet anëtare të BE-së duan që të shmangin rreziqet e ardhshme. Shumë politikëbërës argumentojnë se këto janë arsye që vendet anëtare të BE-së i përdorin për të "fituar kohë", në këtë proces. Pa iu rikthyer premtimit për anëtarësim eventual të rajonit, strategjia e nënkuptuar tashmë është që vendet të kalojnë nga një fazë në tjetrën sa më ngadalë që është e mundur.

Rreziku tjetër, sidoqoftë, është se shtyrja paafat e anëtarësimit në një të ardhme të pacaktuar do të rrezikojë progresin e arritur në konsolidimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. Premtimi për integrim në Bashkimin Evropian është si të thuash "ngjitësi politik" që deri tani ka mbajtur Ballkanin të bashkuar. Por ngjitësi mund të qëndrojë vetëm nëse rezultatet janë të prekshme

dhe konkrete – diçka që sjell përfitime për këtë gjeneratë të politikanëve të pasluftës dhe për përkrahësit e tyre. Tash për tash është krijuar përshtypja në Ballkan se ata po lihen që të presin pafundësisht. Tashmë veçse ekzistojnë shenja shqetësuese se BE-ja është duke humbur ndikimin e saj në rajon. Ajo është treguar e paafte që të bindë partitë boshnjake që të pajtohen qoftë edhe për reforma të kushtëzuara kushtetuese. Përçarjet e saja përbrenda rreth njohjes së Kosovës kanë dobësuar rolin e BE-së gjithashtu. Politika e saj e zgjerimit drejt Maqedonisë është paralizuar si rezultat i çështjes së emrit të pazgjidhur. Në kohën kur vetë anëtarët e BE-së po ballafaqohen me trazira sociale, si mundet që BE-ja t'ia heqë shpresën një rajoni me një histori dështimesh shtetërore dhe të konflikteve të dhunshme? Jostabiliteti në Ballkan është problem kryekëput i Evropës pa marrë parasysh se ku shtrihen kufijtë e BE-së.

S'ka rrugë të shkurtra

Çdo politikë realiste e BE-së duhet të adresojë të dyja rreziqet – rrezikun nga anëtarësimi i parakohshëm dhe rrezikun nga shtyrja e tepruar. Shpeshherë debati rreth këtyre dy rreziqeve kornizohet si zgjedhje në mes "shko shpejt" dhe "shko ngadalë", si qasje për integrimin e rajonit në BE. Por kjo është një zgjedhje e rreme. Në të vërtetë, nuk ka më diçka të tillë si "udhë të shpejtë" për integrim në BE. Që nga viti 2004 dhe 2007, procesi i integritetit është bërë edhe më me shumë kërkesa. Tashmë janë vendosur kërkesa më të vështira për hapjen dhe mbylljen e cilitdo kapitull gjatë negociatave për anëtarësim. Komisioni Evropian tashmë kërkon zbatime konkrete e jo vetëm premtime, për të deklaruar se një vend ka përmbyllur standardet e kërkuara. Prej momentit të aplikimit për anëtarësim deri tek hyrja, vendet anëtare të BE-së kanë së paku 75 pika të vetos për të cilat ata duhet të pajtohen unanimisht që një vend mund të avancojë².

Për t'i rënë shkurt, asnjë vend nuk do të jetë në gjendje që të shkurtojë apo t'u ikë kriterëve. Edhe nëse Kroacia pranohet rreth vitit 2013, ashtu siç pritet, prapë do të kenë kaluar 10 vjet nga data e aplikimit të saj dhe 8 vjet nga data e fillimit të negociatave për anëtarësim. Shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, që kanë mbetur prapa Kroacisë në kapacitetet e tyre për të menaxhuar një agjendë me plotë kërkesa për reforma, nuk mund të shpresojnë që të fillojnë negociatat për anëtarësim para vitit 2012³. Kështu që data më e përafërt për anëtarësim parashikohet përtej vitit 2020. Me një rrugë kaq të gjatë përpara, BE-ja duhet të mendojë se si mund të maksimizojë ndikimin e saj në rajon dhe të fusë shtetet e Ballkanit në një rrugë reformash të pakthyeshme në mënyrë që ato të lëvizin qëndrueshëm drejt të ardhmes evropiane dhe jo prapa në jostabilitet.

Mësimet nga liberalizimi i vizave

Liberalizimi i vizave kohëve të fundit në rajon demonstroi në mënyrë të qartë mekanizmin e politikës së butë të BE-së. BE-ja kishte në dorë një shpërblim tejet atraktiv elektoral dhe përcaktoi shumë qartë kushtet që kërkoreshin për ta fituar atë. Komisioni Evropian monitoroi për së afërmi progresin e bërë dhe lëshoi raporte të rregullta për statusin. Kjo transparencë bëri të mundshëm fillimin e një procesi të shëndetshëm të konkurrencës në rajon. Liderët e Ballkanit punuan shumë që të shmangnin çmimin e humbjes së zgjedhjeve në rast se mbeteshin prapa fqinjëve në këtë proces. Progresi i fundit në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë, pasi që në fillim kishin mbetur prapa në përmbylljen e kushteve të udhërrëfyesit, është rezultat direkt i këtij presioni. Nuk ishte vetëm fakti i

² Shtetet anëtare duhet të pajtohen unanimisht në: pranimin e aplikacioneve nga një vend; dhënien e statusit kandidat për një vend; fillimin e negociatave; hapjen apo mbylljen e secilit nga 35-plus kapitujve; përmbylljen e marrëveshjeve në formë zyrtare; traktatet e pranimi, si dhe datën e pranimi;

³ Teorikisht, Maqedonia mund të fillojë negociatat e pranimi më herët, nëse gjendet zgjidhje për mosmarrëveshjen bilaterale për çështjen e emrit me Greqinë

mbajtjes së një premtimi të largët. Përkundrazi, ishte rezultat i një procesi të strukturuar qartësisht, i dizajnuar që të prodhojë presionin dhe nxitje të nevojshme. Si rezultat, arriti ndryshime reale në politikat e sigurisë së brendshme të shteteve.

Ka tri mësimë të qarta nga përvoja e liberalizimit të vizave. Së pari, në mënyrë që të motivohen reforma të vështira që përfshijnë shumë institucione dhe investime të konsiderueshme, BE-ja duhet të vendosë kushte të qarta dhe të hollësishme me qëllime të qarta politike. Së dyti, BE-ja duhet të ofrojë qëllim të arritshëm afatshkurtër në mënyrë që politikanët vendorë ta dinë se mund të prodhojnë rezultate zgjedhore. Së treti, procesi duhet të jetë transparent sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë që publiku të krahasojë progresin në vende të ndryshme dhe në mënyrë që shoqëria civile të bëjë presion në qeveritë përkatëse. Kjo transformon procesin e tanishëm teknokratik në një domosdoshmëri politike, duke lënë pak hapësirë për politikanët vendorë që të shfajësojnë veten apo të fajësojnë BE-në për mungesën e progresit në vendin e tyre.

Skeptikët besojnë se vendet e Ballkanit nuk posedojnë kapacitetet administrative që të ballafaqohen me sfidat e hyrjes në BE. Megjithatë, përvoja me vizat tregon se si ato mund të ndërtojnë administratat e tyre dhe kjo është shumë inkurajuese. Duke marrë sa më shumë nga politikat e BE-së sa më herët, mund të ndihmojë në de-politizimin e burokracisë shtetërore. Një përpjekje e vazhdueshme për të qenë në të njëjtin hap me fqinjët do të kërkojë nga shteti rekrutimin, trajnimin dhe mbajtjen e ekspertëve në të gjitha fushat. Kjo, nga ana tjetër, mund të reduktojë tundimin e çdo qeverie për të ndërruar stafin administrativ në baza politike. Në këtë mënyrë, procesi i integritit transparent dhe konkurrues do të promovojë administratë më profesionale, dhe politikisht neutrale.

Koha e pyetësorëve

Ka disa hapa në procesin e anëtarësimit. Pasi që një vend të ketë aplikuar për anëtarësim, Komisioni Evropian i dërgon atij një pyetësor, i cili përmban qindra pyetje të detajuara rreth institucioneve të vendit, politikave dhe infrastrukturës. Mbi bazën e përgjigjeve në këtë pyetësor, Komisioni jep një *avis*, apo mendim, mbi kërkesën e vendit për anëtarësim, e cila tregon se kur vendi mund të jetë gati për të filluar negociatat e anëtarësimit. Pasi që vendi të fitojë statusin e kandidatit, Këshilli i Ministrave duhet të marrë një tjetër vendim formal që të fillojnë negociatat e anëtarësimit.

Komisioni pastaj fillon një proces të quajtur “shqyrtimi” – një detyrë e krahasimit të legjislacionit dhe të politikave të vendit me ato të BE-së – në mënyrë që të hartojë plane afatgjata për të sjellë shtetet aplikuese në nivelin e standardeve të BE-së.

Tash për tash secila prej shtatë vendeve të Ballkanit është në faza të ndryshme të procesit (shih tabelën në faqe 9). Kroacia ka statusin e kandidatit, ka filluar negociatat e anëtarësimit në tetor 2005 dhe pritet të anëtarësohet në vitin 2013. Maqedonia gjithashtu ka statusin e kandidatit, por është në pritje të fillimit të negociatave për anëtarësim. Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia kanë aplikuar të gjitha për anëtarësim, por akoma nuk u është dhënë statusi i vendit kandidat. Mali i Zi ka dërguar përgjigjet në pyetësorin e saj vitin që shkoj kurse Shqipëria këtë vit; por që të dyja janë duke pritur nga Komisioni publikimin e një avis-i (apo mendimi). Serbia është akoma duke pritur nga Këshilli që të pranojë kërkesën e saj për anëtarësim. Ndërkohë, Bosnjë- Hercegovina dhe Kosova ende nuk kanë aplikuar për anëtarësim. Gjëja e parë që BE-ja mund të bëjë për të filluar konkretizimin e dinamikës që punoi shumë mirë në rastin e liberalizimit të vizave është që t’u dërgojë pyetësorin të tri vendeve, të cilat akoma nuk e kanë marrë: Bosnjë- Hercegovinës, Kosovës dhe Serbisë.

Këshilli ende nuk ka pranuar aplikacionin e Serbisë për statusin kandidat për t’ia dërguar pastaj Komisionit, sepse disa vende anëtare insistojnë që të presin raporte të mëtejshme mbi bashkëpunimin e Serbisë me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish- Jugosllavi. Gjithsesi, Komisioni duhet që t’i ofrojë Serbisë pyetësorin sa më shpejt që të jetë e mundur. Procesi i pyetësorit, i cili merr deri në gjashtë muaj që të përfundohej, paraqet një detyrë të ndërtimit të kapaciteteve në vetvete. Ajo detyron vendin që të bëjë vlerësimin e vendit se ku qëndron karshi një morie çështjesh, duke u nisur nga kualiteti i statistikave të saj (një çështje kyçe në prag të krizës ekonomike greke) deri tek funksionimi i gjyqësorit të saj.

Bosnjë-Hercegovina, e cila akoma nuk ka bërë aplikimin për statusin kandidat, është një rast edhe më i vështirë. Ajo mbetet e bllokuar në një krizë ndarjeje politike e kushtetuese. Mirëpo, me gjithë këtë prapavijë, Bosnjë-Hercegovina mundet në fakt të përfitojë më shumë nga dhënia e pyetësorit dhe nga fillimi i procesit të shqyrtimit më herët. Kjo do t’u jepte politikanëve të saj një nxitje për të kapërcyer bllokadën e tyre dhe të fillojnë punën në ndërtimin e një administrate funksionale. Në fund të fundit, serbët e Bosnjës, kroatët e Bosnjës dhe politikanët Boshnjakë do të vuajnë të gjithë politikisht në rast se Bosnja mbetet prapa rajonit, e veçanërisht prapa Serbisë. Përvoja nga liberalizimi i vizave tregoi se fuqia e BE-së është më efektive kur Bosnja është subjekt i kushteve të njëjta jonegociuese sikurse fqinjët e saj, sesa kur trajtohet si rast i veçantë.

Detyrat e pyetësorit dhe të ‘shqyrtimit’ do të pajisin Bosnjën me shumë mjete që ajo ka nevojë për ndërtimin e shtetit. Vendi ka nevojë për ndërrimin e sistemit administrativ që funksionon në të gjithë territorin – qoftë edhe përmes centralizimit të funksioneve në nivel shtetëror, qoftë përmes arritjes së

rregullimeve përmes vijave të njërive kufitare. Për shembull; Bosnja ka nevojë për një sistem koherent statistikor në të gjithë vendin. Të gjitha këto procese kanë më shumë gjasë që t'i kthejnë strukturat e ngathëta kushtetuese të Bosnjës në një sistem federal funksional sesa çfarëdo përpjekjeje tjetër për të rinegociuar Kushtetutën si pjesë të ndarë nga procesi i anëtarësimit në BE. Sapo të mbyllet zyra e përfaqësuesit të lartë, Bosnjë-Hercegovina mundet që formalisht të aplikojë për anëtarësim në BE në vitin 2011 me pyetjet tashmë të përgjigjura nga pyetësi i saj. Kjo do të lejonte Komisionin Evropian që të merrej me Bosnjën dhe me Serbinë njëkohësisht, duke përgatitur ndërkohë mendimin e saj për Bosnjën në vitin 2011.

Kosova mbetet rasti më i rëndë nga të gjithë. Ajo madje as nuk mund të fillojë procesin e anëtarësimit, pasi që pesë vende të BE-së nuk e njohin pavarësinë e saj. Në mungesë të procesi të anëtarësimit, BE-ja - e cila ka dërguar një mision prej 1800 vetash me policë dhe gjyqtarë në Kosovë – rrezikon prapambetjen e reformave në fushën e sundimit të ligjit krahasuar me aspekte të tjera të qeverisjes. Mungesa e një perspektive të besueshme e anëtarësimit për Kosovën dëmton fuqinë dhe atraktivitetin e BE-së në vendin e Evropës Juglindore për të cilën ka më së shumti nevojë.

Çfarëdo qofshin ndryshimet e tyre rreth njohjes së Kosovës, asnjë vend i BE-së nuk dëshiron që si rezultat i kësaj progresi i Serbisë të bllokohet. Prandaj, me kushtin që Serbia të përmbushë kërkesat dhe të bashkëpunojë me misionet ndërkombëtare në Kosovë, ajo duhet lejuar që të ecë para në procesin e anëtarësimit. BE – ja duhet të insistojë në masa praktike, siç është kërkesa ndaj Serbisë për njohjen e vulave të doganave të Kosovës për tregti rajonale. Ajo gjithashtu duhet të insistojë dhe të kërkojë nga Serbia që të ndalojë minimin dhe dëmtimin e bashkëpunimit rajonal – gjë që ka qenë shtyllë e politikës së BE-së qëkurse ka

Sa do të kushtojë?

Në kohën kur BE-ja është e shqetësuar me çështje rreth nxjerrjes nga kriza anëtarët ekzistues të saj, është i kuptueshëm hezitimi që t'u japë çfarëdo premtimi apo angazhimi vendeve jashtë BE-së që do të kishte implikime buxhetore. Procesi i "shqyrtimit" do të kërkonte vëmendjen e ekspertëve teknikë nga Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare. Sidoqoftë, propozimet e bëra këtu janë buxhet-neutrale.

Komisioni mund t'u japë pyetësorët Bosnjë- Hercegovinës, Kosovës dhe Serbisë tani dhe të fillojë procesin e 'shqyrtimit' për të gjashtë vendet e rajonit në vitin 2011, duke shfrytëzuar burimet që janë përcaktuar më parë si pjesë e planifikimit buxhetor. Për vendet anëtare të BE-së, vendimi për të filluar procesin e 'shqyrtimit' para negociatave për anëtarësim do të ishte një mënyrë e shpenzimit efektiv që do të çonte një sinjal pozitiv në vendet e Ballkanit duke ndihmuar në parandalimin e krizës së tashme ekonomike, para se ajo të kthehet në një krizë më të gjerë të besimit rreth projektit të kryerjes së reformave e inspiruar nga BE-ja në pjesën e mbetur të Evropës Juglindore. Sigurisht se do të kushtonte shumë më shumë dërgimi i diplomatëve evropianë, oficerëve policorë dhe ushtarëve në Ballkan që të merreshin me paqëndrueshmërinë e re të krijuar.

filluar procesi i stabilizimit në Ballkan në vitin 2000 – duke bllokuar pjesëmarrjen e Kosovës në iniciativa rajonale nga energjia tek transporti.

Por, BE-së gjithashtu i duhet një strategji për Kosovën. Nga cilado pikëpamje që shihet statusi i saj, lënia e Kosovës në harresë do të bëjë që ajo të vazhdojë të mbesë prapa, duke prodhuar tensione të rrezikshme politike duke dëmtuar njëjtë interesat e serbëve të Kosovës dhe të shqiptarëve po ashtu. BE-ja duhet të "ndeze" dialogun për Procesin e Stabilizim-Asociimit – politikën e saj ekzistuese për Kosovën – në një detyrë të plotë paraanëtarësuese, neutrale ndaj

statusit. Në terma konkretë, kjo nënkupton që autoritetet e Kosovës duhet të pranojnë pyetësorin në të njëjtën kohë me Serbinë. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve administrative në Kosovë, do t'i jepte një udhërrëfyes të qartë për kryerjen e reformave lokale, dhe do të forconte punën e organizatave ndërkombëtare dhe të donatorëve duke ofruar informata vitale në një ambient të varfër për nga statistikat.

Shqyrtimi i hershëm

Bashkë me dërgimin e menjëhershëm të pyetësorëve për Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën dhe Serbinë, BE-ja duhet që brenda vitit që vjen të fillojë gjithashtu procesin e shqyrtimit për të gjashtë vendet që akoma nuk kanë filluar procesin. Procesi i 'shqyrtimit' detyron një vend aplikues që të shikojë mirë dhe qartë se sa afër janë në të vërtetë ndaj kërkesave për anëtarësim, duke futur kështu një dozë të nevojshme të realizmit në debatet e tyre sa i përket asaj se çka duhet bërë në vitet që vijnë. Ai gjithashtu u jep të dy palëve; vendeve dhe Komisionit Evropian një hartë të detajuar se çka duhet bërë në secilën fushë, nga siguria e ushqimeve tek zhvillimi rural. Ai ndihmon në përgatitjen e strategjive për mënyrën se si të përdoret ndihma financiare e BE-së dhe këshillat teknike për të prodhuar rezultatet më të mira. Përfundimisht, ai u jep vendeve një pamje reale se ku ata qëndrojnë vis-a-vis fqinjëve të tyre.

Në rastet e Kroacisë dhe Turqisë, vende që hapën negociatat për anëtarësim më së fundi, procesi i 'shqyrtimit' filloi pasi që negociatat për anëtarësim kishin filluar. Sidoqoftë, është në interesin e vetë BE-së që të fillojë procesin në Ballkan sa më shpejt që të jetë e mundur.

Kjo do të pajiste Komisionin Evropian me një informatë të çmueshme për përgatitjen e një avis për vendet të cilat akoma nuk e kanë një të tillë. Nëse Serbia dorëzon përgjigjet nga pyetësi i saj para përfundimit të vitit 2010, Komisioni mund të përgatisë avis-in e



saj në 2011, paralelisht me procesin e 'shqyrtimit'

Komisioni duhet që të ftojë Kosovën gjithashtu që të marrë pjesë në ushtrimet e përbashkëta të 'shqyrtimit' në mënyrë që të mbajë atë në të njëjtën vijë paralelisht. Ky është mekanizmi më i mirë i ndërtimit të kapaciteteve që BE-ja ka në dispozicion. Dhe kjo nuk është çështje e zbutjes së kushteve, por çështje e krijimit të standardeve më rigorozë për matjen e progresit.

Në mënyrë që të promovohet forma e konkurrencës rajonale që funksioni mirë në rastin e liberalizimit të vizave, do të ishte më mirë që të gjitha gjashtë vendet të fillonin procesin e 'shqyrtimit' së bashku, njëjtë sikurse aplikuesit e Evropës Qendrore që vepruan në vitin 1998, sesa ndarazi⁴. Një detyrë e tillë kolektive e 'shqyrtimit' për vendet e Ballkanit do të merrte rreth 6 muaj. Komisioni Evropian do të prezantonte të gjithë trupin ligjor të BE-së, i njohur si; *acquis communautaire*, të të gjitha vendet, por duke bërë vlerësime individuale për institucionet, politikat dhe infrastrukturën për secilin vend veç e veç. Kjo do t'i jepte Komisionit një ide

të detajuar se sa afër është secili vend në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim. Komisioni pastaj do të ishte në gjendje të vlerësonte, nëse një grup vendesh do të mundeshin apo jo të fillonin negociatat për anëtarësim së bashku në vitin 2012. Perspektiva e të qenit pjesë e një grupi udhëheqës do të ishte një vlerë e shtuar për liderët e Ballkanit për angazhim më të shpejtë në procesin e anëtarësimit në BE. Kjo do t'i inkurajonte ata që të merrnin detyrën e 'shqyrtimit' shumë seriozisht gjë që do të ngrite fuqinë e BE-së në një moment të pasigurisë në rritje në rajon.

Një program për ndërtimin e institucioneve

A munden vendet e Ballkanit t'i përballojnë kërkesat e negociatave për anëtarësim në vitet që pasojnë? Sigurisht se akoma nuk ka mjaft shërbyes civilë dhe gjyqtarë të mirëtrajnuar dhe të motivuar të cilët do të zbrërthojnë, zbatojnë dhe vënë në fuqi më shumë se 100.000 faqe të Ligjit të BE-se. Sidoqoftë, negociatat në vetvete përbëjnë një nxitje të fuqishme për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme administrative. Negociatat shërbejnë

për hartimin e planeve të veprimit për krijimin e departamenteve të reja ministrore, thellimin e agjencive të reja, trajnimin e zyrtarëve dhe vendosjen e afateve për aprovimin e politikave dhe legjislacionit. Në mënyrë që t'u mundësohet vendeve të Ballkanit të jenë konkurruese, BE-ja duhet të angazhohet shumë më herët për të përmirësuar funksionet kryesore të shtetit që janë vitale për zbatimin e ligjit siç duhet.

Sapo vendi të fillojë negociatat me BE-në, Komisioni Evropian dërgon më shumë misione, ekspertë, dhe themelon grupet punuese të përbashkëta për të udhëzuar kryerjen e reformave kryesore – për shembull, krijimin e agjencive të konkurrencës dhe rregullimin e gjyqësorit. Ky ndërveprim intensiv teknik me BE-në – duke përfshirë planet e veprimit, programet e trajnimit dhe monitorimin e jashtëm – i jep administratës shtetërore një pikë të qartë të orientimit, si dhe një motivim politik për të pasur një plan konkret të miratuar nga ekspertët e jashtëm.

⁴ Në vitin 1998, BE-ja filloi procesin e 'shqyrtimit' në shtatë shtete me të cilat ishte njëkohësisht duke negociuar, së bashku me pesë vende që akoma nuk kishin filluar negociatat

Vendet negociuese i dërgojnë projektligjet në komision për të parë përputhshmërinë e tyre me legjislacionin e BE-së dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Me kalimin e kohës kjo mund të ketë një efekt të thellë transformues, njëjtë si u dëshmuar vendet e Evropës Qendrore të cilat përdorën procesin e anëtarësimit për të dalë nga e pasiguria paskomuniste tek standardet evropiane dhe më tej. Pas pranimit në vitin 2004, Komisioni kuptoi se anëtarët e rinj po e zbatonin Ligjin e BE-së më mirë sesa anëtarët e vjetër.

Aktualisht vetëm Drejtoria e përgjithshme e Komisionit Evropian që merret me zgjerimin i trajton gjashtë vendet e Ballkanit me përjashtim të Kroacisë si prioritet. Si rezultat, ekspertët sektorialë në drejtoritë e tjera shpesh dështojnë që të angazhohen së bashku me ta. Kjo do të fillonte të ndryshonte me fillimin e procesit 'shqyrtimit' dhe kontaktet me drejtoritë e tjera të përgjithshme, do të intensifikoheshin më tej me hapjen formale të negociatave për anëtarësim.

Përfundim

Këto janë kohëra të vështira për politikën e Ballkanit Perëndimor. Kriza ekonomike e Greqisë dhe e shteteve të

tjera anëtare të BE-së do të afektojnë edhe më tepër ekonominë e dobëta të rajonit dhe do të thellojnë pasigurinë. Dyshimet rreth të ardhmes së projektit evropian në prag të krizës së euros do të mund të largonin votuesit nga reformatorët proevropianë drejt politikanëve nacionalistë dhe populistë. Për këtë arsye mbajtja e vendeve të Ballkanit në pritje pafundësisht, mban në vete një rrezik në rritje.

Megjithatë, është gjithashtu e vështirë që ti angazhosh liderët evropian në Ballkan për momentin. Prandaj rruga më realiste është shfrytëzimi i mjeteve ekzistuese të BE-së më shumë dhe në mënyrë sa më efektive, që të kapen më mirë hapat e ardhshëm drejt anëtarësimit.

Kjo do të përkrahte reformuesit në rajon pa imponimin e ndonjë kostoje shtesë mbi BE-në. Procesi i pranimit nuk mund të përshpejtohet por ai mund të intensifikohet.

Përvoja e fundit me liberalizimin e vizave tregoi që BE-ja akoma ka fuqinë për të nxitur reforma serioze në shtete të dobëta nëse ofrohen incentiva të prekshme. Kjo kërkon kushte të qarta dhe objektive, angazhim të ngushtë në nivel teknik nga Komisioni Evropian dhe ekspertët nga shtetet anëtare, një kornizë kohore të qartë për sa u përket

Mosmarrëveshjet bilaterale?

Mosmarrëveshjet bilaterale, sidomos rreth çështjes së kufijve, mund të provojnë të jenë një pengesë e madhe në procesin e anëtarësimit. Përvoja e BE-së me Qipron e ka bërë BE-në alergjike rreth importimit të çështjeve të pazgjidhura me anëtarët e rinj. Mosmarrëveshja rreth kufirit në mes të Sllovenisë dhe Kroacisë shkaktoi irritime të mëdha duke bllokuar negociatat e anëtarësimit për muaj me radhë. BE-ja duhet të mësojë nga këto përvoja. Ajo duhet të vendosë një standard nëse shtetet nuk mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë bilaterale, gjë që natyrisht është e preferuar, ato duhet të pajtohen t'i nënshtrohen një mekanizmi arbitrazhi që do të zgjidhte mosmarrëveshjen para anëtarësimit.

Kroacia mund të përbëjë një precedent në këtë drejtim: ajo ka çështje të hapura të demarkacionit me Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë, por tashmë ajo është afër zgjidhjes së problemit me Slloveninë. BE-ja duhet të ndërmarë dy hapa të mëtejshëm që të ndajë mosmarrëveshjet bilaterale nga procesi i anëtarësimit. Së pari, ajo duhet të krijojë një kapitull të ri për bashkëpunim rajonal gjatë negociatave që do të ishte vendtakimi i vetëm për diskutimin e çështjeve bilaterale në mënyrë që të parandalohej hapja e kësaj çështjeje në kapitujt e tjerë pasi po shkakton bllokimin e negociatave. Së dyti, BE-ja duhet të fusë një klauzolë të veçantë në çdo traktat tjetër të anëtarësimit – duke filluar me Kroacinë – që t'u parandalojë anëtarëve të rinj të drejtën e vetos për shkak të mosmarrëveshjeve bilaterale. Klauzola duhet të theksojë se ata ose duhet të zgjidhin çështjen miqësisht ose të pranojnë mekanizmin e njëjtë të arbitrazhit që tash është duke u aplikuar për zgjidhjen e çështjes mes Sllovenisë dhe Kroacisë



Fazat e procesit të anëtarësimit: Ku qëndron Ballkani aktualisht

	Kroacia	Maqedonia	Mali i Zi	Shqipëria	Serbia	Bosnjë -Hercegovina
Pranimi i aplikimit-	Shkurt 2003	Mars 2004	Dhjetor 2008	Prill 2009	Dhjetor 2009	-
Këshilli kërkon një mendim (avis)	Prill 2003	Maj 2004	Prill 2009	Nëntor 2009	-	-
Vendi pranon Pyetësin	Qershor 2003	Tetor 2004	Qershor 2009	Dhjetor 2009	-	-
Vendi dorëzon Pyetësin	Tetor 2003	Shkurt 2005	Dhjetor 2009	Prill 2010	-	-
Komisioni publikon avis	Prill 2004	Nëntor 2005	-	-	-	-
Këshilli jep statusin e kandidatit	Korrik 2004	Dhjetor 2005	-	-	-	-
Komisioni rekomandon fillimin e negociatave	Dhjetor 2004	Tetor 2009	-	-	-	-
Negociatat për pranim fillojnë	Tetor 2005	-	-	-	-	-
Negociatat për pranim përmbyllen	Mundësisht 2011?	-	-	-	-	-
Anëtarësimi	Mundësisht 2013	-	-	-	-	-

mundësive dhe vlerësime transparente, të cilat shkaktojnë konkurrencë të shëndoshë ndërmjet vendeve fqinje.

Mekanizmat e njëjtë që punuan për liberalizimin e vizave mund të përdoren për të nxitur reforma të gjëra në Ballkan. BE-ja duhet të fillojë duke dërguar menjëherë pyetësorët për Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën dhe Serbinë dhe duke filluar procesin e 'shqyrtimit' me të gjashtë vendet vitin që vjen. Nga fundi i vitit 2011 – nën Presidencën e parë të Polonisë të BE-së – të gjitha vendet mund të kenë përfunduar procesin e 'shqyrtimit' dhe të arrijnë statusin e kandidatit. Kjo nuk ka të bëjë me koncesione. Përkundrazi, ka të bëjë me vënien në vend të një procesi të drejtë dhe rigoroz që do të motivojë vendet e Ballkanit në identifikimin e të metave të tyre dhe hartimin e planeve për të tejkaluar ato. Duke vepruar kështu, BE-ja do të përmbushte angazhimet e saja të bëra në Samitin e Selanikut në vitin 2003, sikurse do të vazhdonte ndërtimin e suksesit të saj në rajon gjatë dekadës së fundit, duke

shmangur kthimin në një të kaluar të rrezikshme.

(Autorët: **Heather Grabbe** është drejtoreshë e Institutit për Shoqëri të Hapur në Bruksel dhe anëtare e Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Ajo ishte këshilltare e lartë e Komisionerit për Zgjerim, Oli Rehn, përgjegjëse për Ballkanin dhe Turqinë nga viti 2004 deri në 2009. Ajo gjithashtu kohëve të fundit ishte zëvendës drejtoreshë e Qendrës për Reforma Evropiane dhe njëherësh akademike duke specializuar në politikën evropiane në Institutin Royal për Marrëdhënie Ndërkombëtare, në Universitetet e Birminghamit dhe të Oksfordit, në Institutin Universitar Evropian dhe në London School of Economics; **Gerald Knaus** është anëtar në Qendrën Carr të shkollës për qeverisje Harward Kenedy, themelues dhe udhëheqës i Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI) dhe anëtar themelues i Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Ai ka ligjruar Ekonominë në Universitetin Chernivtsi në Ukrainë dhe ka punuar për nëntë

vjet në Bullgari, Bosnjë dhe Kosovë si gazetar dhe ka punuar për organizata të ndryshme duke përfshirë ICG (Grupin Ndërkombëtar të Krizave – GNK) dhe Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë (OHR). Ai ishte drejtor i njësisë Mësimet e Mësuarat të shtyllës së BE-së në kuadër të UNMIK-ut nga viti 2001 deri në vitin 2004; **Daniel Korski** është anëtar i lartë për politika në Këshillin Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Ai para pak kohëve ishte zëvendës drejtor i njësisë britanike për rindërtim paskonfliktual; këshilltar i ministrit afgan kundër narkotikëve dhe udhëheqës i skuadrës së rindërtimit krahinor në Barsa në Irak. Ai gjithashtu punoi si këshilltar politik për Paddy Ashdown, ish-përfaqësues i lartë për Bosnjë - Hercegovinën; këshilltar për politika në Komisionin e Mbrojtjes në Shtëpinë e Popullit (House of Commons/ Parlamenti Britanik))

(E drejta për publikimin integral të këtij raporti është siguruar nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Ky publikim përfaqëson qëndrimin e autorëve.)



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society